


**UNIVERSITETI I EJL
JHE YHIBEP3ITET
SEE UNIVERSITY**



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
FAKULTETI I GJUHËVE KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

PUNIM MAGJISTRATURE

TEMA: “dramat për fëmijë të abdlazis islamit”

Kandidati:

Albane Berisha

Mentori:

Prof. dr. Zeqir Kadriu

Tetovë, 2019

Abstrakt në shqip

Letërsia për fëmijë në përgjithësi, si disiplinë e veçantë e letërsisë shqiptare, në të kaluarën është injoruar dhe nuk është çmuar sa duhet. Do të thotë, ajo si e tillë është përjashtuar, jo në tërësi, po pjesërisht, nga mësimi i letërsisë, është marginalizuar duke u konsideruar si jo aq e rëndësishme dhe me vlera letrare artistike të kontestueshme. Mohimi i tillë i kësaj letërsie është i paarsyeshëm dhe i paqëndrueshëm, për arsye se sot shumë shkrimtarë, qoftë të huaj, ose tanë, shkruajnë vepra të gjinive të ndryshme, të cilat posaçërisht ua dedikojnë fëmijëve dhe të rinjve.

Ky studim ka për qëllim argumentimin se dramat e Abdylazis Islamit (“Agimesha e ngujuar në shtatë shpella”, dramë për fëmijë – duhesh theksuara se njëherë është botuar si libër prej 2000 ekzemplarësh. U shit për një kohë rekord brenda dy javësh. Tash është paraparë si lektyrë shkollore, për klasën e pestë dhe si e tillë duhet të botohet në shumë ekzemplarë.

Abstract

Children's literature in general, as a special discipline of Albanian literature, has in the past been ignored and not appreciated enough. That is to say, as such it has been excluded, not entirely, but in part, from the teaching of literature, it has been marginalized as being less important and of contested artistic value. Such a denial of this literature is unreasonable and unsustainable, because many writers today, whether foreigners or ours, write works of different genders, specifically dedicated to children and young people.

This study aims to argue that the plays of Abdylazis Islam children's drama - should be noted that it was once published as a book of 2000 copies. It was sold for a record time within two weeks. as a textbook for fifth grade and as such it should be published in many copies

PËRMBAJTJA:

ABSTRAKT NË SHQIP.....	2
ABSTRACT.....	3
HYRJE	3
LËNDA E HULUMTIMIT	6
QËLLIMET E HULUMTIMIT	9
HIPOTEZAT.....	12
1.HIPOTEZA GJENERALE	12
METODAT E PËRDORURA PËR HULUMTIM	12
RËNDËSIA E PUNIMIT.....	13
KAPITULLI I PARË	15

1.0 LETËRSIA PËR FËMIJË- VËSHTRIM I PËRGJITSHËM	15
1.2 LETËRSIA E PËRBOTSHME PËR FËMIJË.....	17
1.3 RILEXIMI DHE RIVLERËSIMI SHKENCOR I LETËRSISË PËR FËMIJË.....	18
1.4 POEZIA PËR FËMIJË	20
1.5 PROZA PËR FËMIJË – TREGIMI DHE ROMANI	22
1.5 DRAMA PËR FËMIJË.....	25
1.5.1 DRAMA SHQIPE PËR FËMIJË, AUTORË DHE VEPRA	26
KAPITULLI I DYTË.....	29
2.1 PORTRETI LETRAR I ABDYLAZIS ISLAMIT.....	29
KAPITULLI I TRETË.....	37
3.0 DRAMA PËR FËMIJË TË ABYLAZIS ISLAMIT.....	37
3.1 STRUKTURA E DRAMAVE PËR FËMIJË.....	39
3.1.1 ANALIZË E DRAMËS PËR FËMIJË E TË RINJ “MRIZONI DHE EURIDIKA”.	41
3.1.2 ANALIZË E DRAMËS PËR FËMIJË AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA.....	47
3.1.3 ANALIZË E DRAMËS PËR FËMIJË KUVENDI I GUXIMTARËVE	50
3.1.4 ANALIZË E DRAMËS PËR FËMIJË ARIANDA.....	53
KAPITULLI I KATËRT.....	Error! Bookmark not defined.
4.RECEPTIVI I DRAMAVE TË ABDYLAZIS ISLAMIT.....	Error! Bookmark not defined.
7.PËRFUNDIMI	57
8.BIBLIOGRAFIA	58
PËRMBAJTJA:.....	3

HYRJE

Në fushën e letërsisë për fëmijë në përgjithësi, janë bërë studime serioze nga studiuesit e të gjitha trevave shqiptare, si të Shqipërisë, Kosovës ashtu edhe të Maqedonisë dhe falë krijimeve dhe studimeve të tyre, letërsia shqiptare për fëmijë, lirisht mund të themi se lulëzon në hapësirën tonë ballkanike, po edhe më gjerë. E njëjta si tezë e përgjithshme, por nëse ndalemi të studiojmë dramën shqipe për fëmijë në letërsinë shqiptare të Maqedonisë, del e dhëna jo shumë e favorshme. Drama për fëmijë, si një fushë e veçantë e letërsisë për fëmijë, krahasuar me romanin për fëmijë, mendoj që ka ende tema të pashtruara shkencërisht, sidomos nga aspekti psikologjik i ballafaqimit të fëmijës me botën aktuale në të cilën jeton.¹

Synimi i këtij punimi është të ndriçojë disa segmente të dramës për fëmijë, të autorit ndër më të njohur të letërsisë për fëmijë në Maqedoni, tashmë të ndjerit, Abdylazis Islamit, të studiohen si nga aspektet psikologjike, krahasuar ndërmjet botës së tij dhe botës reale dhe gjithashtu, paraqet ky studim masteri tregon dhe një përpjekje për të analizuar dramën tonë për fëmijë, për të ndriçuar vlerat edukative, etike, estetike dhe të tjera, të rëndësishme për zhvillimin intelektual dhe ndërtimit të personalitetit të fëmijës. Dhe mund të konstatojmë se përgjithësisht, kjo fushë e letërsisë nuk është studiuar ende sa duhet, shumë çështje në dramën tonë për fëmijë, kanë mbetur të pazbërthyera, të pashpjeguara sa duhet, ose të paprekura fare, kurse një varg relacionesh fundamentale ndërmjet personazheve të dramave dhe analizën e personazheve fëmijë, nuk kanë arritur të ndriçohen sa duhet, nga prizmi psikologjik i lexuesit të vogël. Drama e Abdylazisit Islamit, drama për fëmijë, për të qenë e përfillur dhe për të gravituar në botën e fëmijëve, duhet që t'i kemi njohuritë e përgjithshme të psikologjisë fëmijërore dhe të botës emotive të tyre. Prandaj kësaj problematike i kemi dhënë një rëndësi të veçantë, duke dhënë sqarime të hollësishme nga shkenca e psikologjisë, ndaj segmenteve më të rëndësishme të psikologjisë së fëmijëve, emotivitetit dhe inteligjencës emocionale të tyre.²

¹ Jo vetëm që mungon një analizë serioze e qasjes psikologjike të dramës sonë për fëmijë, por mungojnë edhe tema të nevojshme, që kanë të bëjnë me botën aktuale fëmijërore, krahas zhvillimit bashkëkohor tekniko – teknologjik.

² Spektrit psikologjik dhe emotiv të fëmijëve ia kemi kushtuar një kapitull të tërë, ku jemi mbështetur në thëniet e psikologëve, pedagogëve etj. dhe të veprave të tyre.

Ndaj objektivave të shtruara të qasjes psikologjike, didaktike të dramës, janë marrë parasysh kriteret relevante të psikologjisë fëmijërore, të pedagogjisë dhe fenomenet e psikës së tyre, me qëllim të ndriçimit sa më cilësor të temës.

Në fillim duhet theksuar se tema e paraqitur synon të japë një kontribut modest shkencor për letërsinë për fëmijë, letërsinë të cilën sikur e kemi lënë anësh, pa studime të mirëfillta, aq më pak kur kjo letërsi ka autorë dhe vepra të cilat duhet studiuar, ngjashëm ndodh dhe me rastin tonë, dramat e shkrimtarit të njohur por jo sa duhet në Kosovë dhe më tej, Abdylazis Islami. Kjo mosnjohje nuk ka ardhur nga kriteret jashtëletrare, si ato të ndarjeve të shteteve tona, moskomunikimeve brendakulturore shqiptare, takimeve të rralla shkencore etj.

Letërsia për fëmijë në përgjithësi, si disiplinë e veçantë e letërsisë shqiptare, në të kaluarën është injoruar dhe nuk është çmuar sa duhet. Do të thotë, ajo si e tillë është përjashtuar, jo në tërësi, po pjesërisht, nga mësimi i letërsisë, është marginalizuar duke u konsideruar si jo aq e rëndësishme dhe me vlera letrare artistike të kontestueshme. Mohimi i tillë i kësaj letërsie është i paarsyeshëm dhe i paqëndrueshëm, për arsye se sot shumë shkrimtarë, qoftë të huaj, ose tanë, shkruajnë vepra të gjinive të ndryshme, të cilat posaçërisht ua dedikojnë fëmijëve dhe të rinjve. Një pohim të tillë e vërtetojnë edhe studimet e ndryshme kushtuar krijuesve të letërsisë për fëmijë (ndonëse numri i tyre te ne ende është i vogël).

Lënda e hulumtimit

Tema e propozuar ka lëndë hulumtimi dramat për fëmijë të Abdylazis Islamit.: “Agimesha e ngujuar në shtatë shpella”, dramë për fëmijë; “Kuvendi i guximtarëve”, dramë për fëmijë; “Arianda”, dramë për fëmijë. Hulumtimi do të organizohet me qëllim që të nxirren në sipërfaqe analiza dhe komente rreth krijimtarisë së begatë të këtij poeti, shkrimtari dhe dramaturgu nga Maqedonia, veprën e të cilit mund të themi se në periudha të caktuara ka qenë e izoluar nga sistemi edhe pse veprimtaria e tyre shtrihej në një kompas të ngushtë si: Kosovë e Maqedoni, por jo edhe në Shqipëri apo edhe në atarin e përgjithshëm gjeografik mbarëshqiptar dhe se meritojnë trajtime më serioze dhe më të përkushtuar. Fati i keq i popullit shqiptar që jeton në Maqedoni, ngjashëm si fat ka dhe letërsia e tyre, dhe si e tillë ajo nuk është përfshirë sa duhet në shtrirjen e gjeografisë letrare të shqiptarëve në mbarë territorin shqipfolës; për rrethanat dhe

arsyet të cilat kanë qenë të njohura deri në periudhën e viteve të 90-ta, por dhe sot ka pak vështrime dhe referenca studimore.

Studiuesi i vetëm i cili është marrë seriozisht me veprën e autori të harruar nga kritika letrare, prof.dr Zeqir Kadriu me rastin e mbajtjes së konferencës shkencorë kushtuar dy kolosëve të letërsisë shqipe që krijohet në Maqedoni, Murat Isakut dhe Abdylazis Islamit, në studimin e tij, shprehet: “Gjer më sot kritika e mirëfilltë e ka thënë fjalën për poetin, po hapësirë për të thënë ka edhe më tej, pasi një vepër kaq voluminoze jep shkas edhe për thellime të mëtejme. Jo rastësisht nga shumë figura eminente do të cilësohet si një njeri që ecte përmes dy binarëve që shkonin paralelisht dhe pasqyronin në vete edhe refleksionin tradicional edhe atë modern; gjë që e fut poetin në hapësirën kulturore të universit të hartës gjeografike kombëtare bile dhe me përmasa më të gjera”.³ Zeqir Kadriu, në studimin e tij monografik kushtuar jetës dhe veprës letrare të krijuesit, me titull “NGADHËNJIMI I FJALËS (Universi poetik i Abdylazis Islamit)”, ai na sjell monografinë më të plotë të veprës së tij dhe si e tillë mbetet ende referenca e parë serioze të cilës më pas i rreshtohen dhe disa studime të Rexhep Qoses, Ali Aliut, Ahmet Selmanit, Salajdin Salihit, Fatmir Sulejmanit, Fatmir Terziut, Emine Shabanit etj.

Falë modestisë së tij dhe tërheqjes në vetvete shkrimtarit i mbetën pa botuar më se pesëmbëdhjetë vepra që në një të ardhme është e domosdoshme që të shohin dritën e botimit.⁴

1. Sot kujtoj që është e rrugës të ndalem në një segment (të ngushtë) që Abdylazisin e bën më të fuqishëm më të gjallë dhe kurrë të pavdekshëm.

2. Kjo pikërisht është edhe forca e tij madhore dhe intelektuale që tërhoqi vëmendjen e madhe të kritikës.

3. Dëshmoi fuqinë vrojtuese dhe përfytyruese; veçanërisht me veprën “Soditje nga Toka” (Prishtinë, 1969) Zeqir Kadriu

4. Zhvilloi harmoninë e mendimit dhe ndjenjës poetike;

³ Kadriu Zeqir, „ Dekada e heshtjes dhe dhembjes krenare Abdylazis Islami; Në jetë i qetë në shpirt tërmet! “ Konferenca IX Shkencore Ndërkombëtare me temë “Veprimtaria letrare e Abdylazis Islamit dhe Murat Isakut” (me rastin e 10 vjetorit të ndarjes nga jeta), mbajtur më 20 nëntor 2015 në UEJL, Tetovë, f. 14

⁴ Po aty, 14-16

5. Kultivoi fuqishëm metaforat e vendlindjes;
6. Eci i pamposhtur në evoluimin e mëtejshëm poetik;
7. Nuk u dorëzua po ngeli i pathyeshëm gjatë sfidave të jetës;
8. Kultivoi filozofinë e mirëfilltë të jetës dhe gjenezës kombëtare;
9. Udhëtoi vertikalisht nëpër historinë kombëtare;
10. Poezinë dhe gjinitë tjera i kultivoi si filozofi dhe etikë letrare;
11. Bëri thjeshtëzimin e komunikimit po nuk prodhoi poezi të thjeshtëzuar;
12. Kurrë nuk e futi mendimin e vet në gracka të gjuhës ezopike (po krijoi romanca të një nate vere);
13. Dhe kohët e fundit kur kishte kaluar më se 40-vjet krijimtari e quante veten “Një udhëtar plak” që me krijimtarinë e tij hyri ballëllartë në historinë kombëtare.(Kurrë nuk u fut me zor në zik-zaket e jetës siç e provuan ca të tjerë), por qëndroi besnik pa shkruar as edhe një varg apo një rresht për kolltukxhinjtë e kohës!

14. Shkoi i zhuritur, pse e kaluara e hidhur i djeg këmbët e të sotmes edhe më tej!

Shkroi poezi,tregime, romane, drama; merrej edhe me kritikë letrare dhe eseistikë, merrej me mbledhjen dhe studimin e folklorit shqiptar të Sharrit; merrej edhe me përkthime letrare nga maqedonishtja dhe kroatishtja. Që në atë moshë bashkëpunoi me të gjitha gazetat e revistat që botoheshin në gjuhën shqipe në Shkup, Prishtinë e Podgoricë. Ai shkroi në të gjitha gjinitë letrare dhe la një numër të madh veprash në poezi e prozë për fëmijë e të rritur. Disa nga veprat e tij janë përkthyer edhe në gjuhë të tjera.⁵

Në këto vepra autorët e kësaj ane trajtojnë psikologjinë e njerëzve të Bjeshkëve të Sharrit, efektet e luftës që shtrihen deri në Malësinë e Sharrit; paraqitjen e tablove mbi rrugën e mundimeve të shqiptarëve dhe popujve të Ballkanit për çlirim nga robëria osmane; se është një roman i frymëzuar nga një çast historik; se afirmonte përpjekjet e shqiptarëve për një mbijetesë

⁵ Kadriu Zeqir, Bota poetike e Abdylazis Islamit, (studim monografik), faqe, 21

ekzistenciale, se këtë e arrinte nëpërmjet një *depërtimi psikologjik në botën e personazheve; dhënies së detajeve të shumta zakonore, etnografike, etnopsikologjike etj*⁶.

Qëllimet e hulumtimit

Objektivi tjetër i këtij punimi është efekti i dramës për fëmijë dhe ndikimi i tij në psikologjinë e fëmijës, pastaj reflektimi i vlerave edukative arsimuese në personalitetin e tij, si dhe përjetimi estetik i romanit nga ana e lexuesit fëmijë. Vëmendje të veçantë u kemi kushtuar edhe fenomeneve të ndryshme të sferës psikologjike p.sh., pranimi dhe përkufizimi i dukurive të ndryshme, koncepti i dëshirës për ngadhënjimin e personazheve pozitive etj.

Drama shqipe për fëmijë është prozë nacionale, njësoj si ajo e të rriturve, i takon gjuhës shqipe, kulturës shqiptare, traditës së letërsisë shqiptare, ka historikun dhe proceset zhvilluese të kombit por përmes minimizimeve tematike të kapshme për fëmijë e të rritur.

Natyrisht se vetë përmbajtjet nacionale (siç janë: temat historike, toponimet e ndryshme gjeografike etj.), romanin tonë për fëmijë e përcaktojnë si roman nacional.

Por elementi themelor në përcaktimin e dramës në sferën nacionale është gjuha, ndërsa nga ana tjetër, fëmijët sipas projeksionit të botës se tyre janë jonacionalë dhe nuk i përkasin asnjë kategorie klasore apo racore, ata i takojnë botës ideale të barabarësisë. Gjatë kohës së procesit të përvetësimit të botës së të rriturve, si botë të tyre, fëmijët vetëdijësohen për dallimin në mes njerëzve dhe fillojnë t'i adaptojnë cilësitë e botës së huaj, asaj empirike dhe këtë dukuri e kemi të shpeshtë në zhvillimin e situatave të ndryshme në dramën tonë për fëmijë.

Drama shqipe për fëmijë duhet të legjitimohet në rend të parë në nivelin artistik, edukativ dhe moralizues, sepse nëse drama për fëmijë nuk është e krijuar, para se gjithash për botën e fëmijëve, për nevojat e tyre imanente, atëherë efektet e kërkuara aspak nuk do të mund të jenë pozitive, meqë do të ishin të imponuara nga bota e huaj me doktrina të ndryshme dhe romani do të pushonte të ekzistojë si dramë për fëmijë.

⁶ Shih: V. Bajkushi, "Kundërime realiste të së kaluarës sonë", Jeta e re, nr.6, Prishtinë, 1980; Abdylaziz Islami, "Vështrim mbi romanin Plagët", Rilindja, Prishtinë, dt. 1.2.1976 etj.

Drama jonë për fëmijë, sipas parashikimeve tona, legjitimohet si prozë humane me vlera të ndryshme edukative, didaktike, psikologjike dhe estetike. Mesazhi i tij e tejkalon kufirin nacional, ndërsa gjuha, përmbajtja dhe tema janë kombëtare.

Ky studim ka për qëllim argumentimin se dramat e Abdylazis Islamit (“Agimesha e ngujuar në shtatë shpella”, dramë për fëmijë – duhet theksuara se njëherë është botuar si libër prej 2000 ekzemplarësh. U shit për një kohë rekord brenda dy javësh. Tash është paraparë si lektyrë shkollore, për klasën e pestë dhe si e tillë duhet të botohet në shumë ekzemplarë⁷; “Kuvendi i guximtarëve”, dramë për fëmijë; “Arianda”, dramë për fëmijë), të cilat ngërthejnë përbrenda *botën e fantazisë dhe të kureshtjes, rrokin sensibilitetin e lexuesit fëmijë, bashkëndjehen situatat përngjasuese me ato të jetës reale, dominon fantastikja, përshkrimet janë tipike sharrjane. Pas leximit të dramave gjejmë personazhet e tyre, diskursin e tyre, filozofinë dhe psikologjinë e tyre, kontaktet kulturore, imazhin që ato krijojnë brenda një vepre të caktuar tipike për letërsinë për fëmijë. Leximi studimor, duhet ndalur në të veçantat e këtyre dramave, “Agimesha e ngujuar në shtatë shpella”, dramë për fëmijë; “Kuvendi i guximtarëve”, dramë për fëmijë; “Arianda”, dramë për fëmijë, paraqet punë të gjerë, lexim dhe rilexim, konsultime me studiues dhe njohës të problematikave që ka studimi i dramës, gjetje të rralla të elementeve strukturore dhe kompozicionale përbrenda tekstit, personazhi fëmijë dhe studimi i botës së brendshme të tij, personazhi narrator dhe tipologji të tjera të personazheve, fabula dhe miti, fantazia dhe realja...*

Dramat e tij (“Agimesha e ngujuar në shtatë shpella”, dramë për fëmijë; “Kuvendi i guximtarëve”, dramë për fëmijë; “Arianda”, dramë për fëmijë) janë lidhur një mijë fije me jetën reale të autorit dhe poetikës së hapësirës sharrjane. Emri i tij lidhet me njërën nga periudhat më të vështira në politikën dhe zhvillimet historike shqiptare në Maqedoni. Kontributi i tij lidhet jo vetëm në fushën e dramaturgjisë, po studimi ynë ateron pikërisht në këtë pistë studimore, në dramat e tij për fëmijë. Nga këndeje edhe veprës së tij nuk i është kushtuar kujdesi dhe vëmendja e duhur jo vetëm sa që gjallë, por edhe pas vdekjes. Studiuesi dhe mik i poetit Prof.dr. Ejup Ajdini për Abdylazis Islamin thoshte : Është një erudit në vete, andaj është vështirë t’i hysh një studimi të veçantë për krijimtarinë e tij. Jo vetëm për atë se, volumi i tij krijues është shumë i madh, jo vetëm për shumëllojshmërinë e zhanreve që ai trajton, duke filluar me poezinë dhe pastaj për të arritur me romanin, tregimin, dramën, novelën, poemën, mbledhjen e folklorit etj.

⁷ Zeqir, Kadriu, Bota poetike e Abdylazis Islamit, (studim monografik), Blana, Tetovë, 2003, f.185

Veçmas u dallua në krijimin e sonetit, që në letrat shqipe është më i rrallë. Por, vështirësia qëndron edhe për nga mënyra se si i trajton dhe i shkruan veprat e tij letrare, pasi i veçantë është edhe te veprat për të rritur edhe te veprat për më të rinjtë. Vepra dramaturgjike e tij, e lënë në heshtje deri në kohën tonë, është një shprehje e gjendjes së përgjithshme të letërsisë aktuale. Duke lexuar dhe analizuar veprën e tij do të vërejmë se te Abdylazis Islami gjejmë univerversin e vendlindjes, personazhin e këndshëm për lexuesin fëmijë, strukturën e tekstin të këndshëm për lexim dhe rilexim. Në të vërtetë, vendlindja e Abdylazis Islamit, të cilën na e ofron përmes një ligjërimi figurativ, në të cilin, në të parë, figurat na duken mjaft të eksploatuara, është fshati ynë: me kulla të shpërndara e të vetmuara e ura gati të rrënuara, fshat ky që e kemi hasur sa e sa herë në letërsinë tonë. Në vendlindjen e Abdylazis Islamit gjendja sociale është rrjedhë e shumë brengave, dramave, historive pikëlluese. Këtë nuk e ilustron vetëm udha e pafund e kurbetçarëve. Megjithatë, ka diçka në atë tokë gurore që e inkurajon poetin, që poezinë e tij e bën të gjallë, optimiste dhe të shpresosh në gjithë atë që shpalohej para poetit dhe nesh, ai është morali e vitaliteti i njeriut të maleve tona, karakteri i tij i fortë, që nuk jepet para së keqes e presioneve, ngado që vijnë. Kjo forcë jetëbesimi hetohet në tekstin e tij, megjithëse, siç thotë poeti, në atë skenë të hapur malore: “nuk mund për çdo gjë të shkruaj”. Skepsa nuk është vështirë të kuptohet, as të arsyetohet.

Në studimin e tij kritikut letrare Agim Vinca, me rastin e vdekjes së poetit Murat Isakut, nga Parisi shkruan : Bota ka ecur përpara kurdo që ka ditur t’i çmojë vlerat dhe krijuesit e tyre. Kur e them këtë kam parasysh faktin që para së gjithash Tetova, por edhe shqiptarët në Maqedoni dhe, pse jo, edhe bota shqiptare në përgjithësi, do të dijë t’i nderojë ashtu si duhet dhe siç e meritojnë Murat Isakun, por edhe bashkëvendësin dhe mikun e kolegun e tij Abdylazis Islamin, duke dëshmuar kështu se ka konsideratë për veten dhe ardhmërinë e vet.⁸

⁸ Vinca, Agim, Poetika e fjalës, Tetovë, 2010, f.209

Hipotezat

1.Hipoteza e përgjithshme

Këto drama që në fillim duhet të themi se nuk janë studiuar. Ka disa argumente se “Agimesha e ngujuar në shtatë shpella”, dramë për fëmijë; “Kuvendi i guximtarëve”, dramë për fëmijë; “Arianda”, dramë për fëmijë. Dramat e tij për fëmijë përshkohen nga atmosfera e ngrohtë, optimizmi, hareja por edhe shqetësimet, problemet dhe pesha e rëndë e jetës në kushtet bashkëkohore duke nxitur iniciativa për punë të zellshme me të cilën mund të sigurohet e ardhmja e sigurtë dhe jeta e fisnikëruar. Dramat janë në nivelin që te lexuesit mund të krijojnë besimin te teksti për të marrë përsipër kënaqësinë me temë nga bota e fëmijëve. Aty ato gjejnë shembullin pozitiv, kultivimin e virtytit dhe cilësive të mira morale te fëmijët, lind aftësia për të depërtuar në psikologjinë e fëmijëve, në brishtësinë e botës së tyre të shpenguar, momente të sinqeritetit, motivin ekzistencial për fëmijët. Kësisoj, konflikti dhe gjithë aksioni i tyre përligjet artistikisht dhe në mënyrë të mençur duke u dhënë fëmijëve të drejtën morale për të luftuar kundër "prishësve" të lojës. Në këto drama me portretin tipizues të naivitetit fëmijëror gjejmë edhe humorin e natyrës burleske. “Agimesha e ngujuar në shtatë shpella”, dramë për fëmijë; “Kuvendi i guximtarëve”, dramë për fëmijë; “Arianda”, dramë për fëmijë vazhdojnë të mbeten të këndshme për lexime dhe si të tilla janë edhe pjesë e programeve mesimorë të shkollave fillore në kuadër të lektyrave shkollore.

Metodat e përdorura për hulumtim

Për t’u përgatitur ky punim shkencor, janë përdorur këtë metoda;

1. Metoda teorike
2. Metoda komparative (krahasuese)
3. Metoda deskriptive; dhe

4. Metoda analitike

Rëndësia e punimit

Drama (si lloj i artit letrar), në rrafshin e komunikimit ekzistencial, përfaqëson fushën ndërvepruese ku vetëdije të ndryshme njerëzore, në përballje me njëra-tjetrën, i provojnë mundësitë e kufijve të ekzistencës së tyre në një proces verifikimi, negocimi, kontestimi, pranimi apo refuzimi të të dhënave të tyre. Drama, është fusha që i ndriçon këta kufij dhe ndriçohet prej tyre. Në dramë dhe në artin teatror - shprehur me konceptet e fizikës moderne - si fusha që përfaqësojnë “energji” dhe përmes personazheve-imazhe që përfaqësojnë “masë” (kufijtë e të cilëve janë të pandarë), shpërfaqet drejtpërdrejtshmëria e intensitetit të forcave tërheqëse e refuzuese të jonjerëzores brenda njerëzores. Objektet dhe perceptet drama i sjell si personazhe-imazhe dhe përmes vizualizimit ato përjetohen dhe perceptohen si afekte e percepte. Në këtë mënyrë, me parimin e vet dialogjik, drama i rrit fuqinë e “vizualitetit të vizuales”, duke ndikuar ashtu në vullnetin tonë për formimin e qëndrimit ndaj të vërtetës, si përcaktuese qenësore e modusit të të bërit të vetes sonë në botë.

Abdilazis Islami si një poet, tregimtar, romancier, publicist, dramaturg, eseist, përkthyes letrar dhe mbledhës i folklorit shqiptar, është munduar që në brendi të romaneve të tij të mos e lërë anash të kaluarën, si për nga tradita, nga intrigat e pushtetarëve të më hershëm, nga zakonet, dhe nga realiteti që ka ekzistuar dikur, nga feja, etj., por edhe nga rethanat kulturore të kohës. Vjershën e parë për të rritur e botoi po te “Flala e Vëllazërimit”, por edhe në revistën e vetme letrare “Jeta e re”, nr3/1956, me titull: “Vodheja” dhe të nënshkruar me pseudonimin A.SH. Idrizi.⁹ Këtë gjë e ka bërë me qëllim që brezat e ardhshëm kur të lexojnë të kuptojnë se çka ka ndodhur me vendin dhe në komunitetin e familjen e tyre. Pra kjo rrëfen njëkohësisht edhe mundimet, për skamjen për nënvlerësimet që kanë ndodhur në institucione nga pala e pushtetarëve të atëhershëm. Veprimtaria e tij është e përqendruar në thujtë të gjithë zhanret

⁹ Zeqir, Kadriu, Bota poetike e Abdylazis Isamit, (studim monografik), Blana, Tetovë, 2003, f.25

letrare, por dramat e tij për fëmijë paraqesin një specifikë të veçantë dhe një vlerë të pamohueshme të historisë së dramës shqipe në përgjithësi.

KAPITULLI I PARË

1.0 LETËRSIA PËR FËMIJË- VËSHTRIM I PËRGJITSHËM

Letërsia jonë për fëmijë është një degë e rëndësishme në kuadrin e letërsisë sonë të përgjithshme kombëtare, ajo është një art, ku bota të cilën e jetojnë fëmijët shprehet, bisedohet, synohet, veprohet, shkruhet, vizatohet, këndohet, gëzohet, lozet, hidhërohet, qahet, sipas perceptimit të jetës dhe botës nga aspektet e tyre. "Në vështrimet e deritanishme historiko – letrare për procesin e letërsisë për fëmijë, veçohen dy periudha më prodhimtare, e rrjedhimisht më të pasura me vlera letrare – artistike: periudha e Rilindjes Kombëtare dhe ajo pas viteve ‘ 50 e deri më sot’".¹⁰

Ky mision profetik i letërsisë për fëmijë dhe i romanit në veçanti, që plotësohet me mjaft përkushtim dhe vëmendje nga ana e autorëve të veprave për fëmijë, pa dyshim, ka funksion të pakontestueshëm në ndërtimin e personalitetit të fëmijës dhe trasimin e rrugës për një jetë të mirëfilltë shpirtërore, psikologjike dhe intelektuale në jetën e tij. "Shija e ndërtuar dhe e stërholluar, në të vërtetë në art i kushtohet senzibilizimit dhe akumulimit të kulturës që zanafillën e ka në fëmijëri, më saktë në veprat e para letrare të asaj periudhe kohore. Në atë shije të sendërtuar, njeriu heton sensin e hollë estetik të cilin e kanë mbjellë veprat letrare për fëmijë dikur në fëmijëri, në botën e tij të brendshme shpirtërore. Ky fakt flet mjaft për rëndësinë e letërsisë për fëmijë që thithet herët, e që më vonë mësyn drejt rrafsheve të tjera më të larta gnoseologjike, në të cilat sendërohet shija për art. Ky mision profetik i letërsisë për fëmijë dhe i romanit në veçanti, që plotësohet me mjaft përkushtim dhe vëmendje nga ana e autorëve të veprave për fëmijë, pa dyshim, ka funksion të pakontestueshëm në ndërtimin e personalitetit të fëmijës dhe trasimin e rrugës për një jetë të mirëfilltë shpirtërore, psikologjike dhe intelektuale në jetën e tij. "Shija e ndërtuar dhe e stërholluar, në të vërtetë në art i kushtohet senzibilizimit dhe akumulimit të kulturës që zanafillën e ka në fëmijëri, më saktë në veprat e para letrare të asaj periudhe kohore. Në atë shije të sendërtuar, njeriu heton sensin e hollë estetik të cilin e kanë

¹⁰ Akademia e Shkencave- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Ramazan Çadri, "Letërsia si e tillë". Fq. 306. Tiranë, 1996.

mbjellë veprat letrare për fëmijë dikur në fëmijëri, në botën e tij të brendshme shpirtërore. Ky fakt flet mjaft për rëndësinë e letërsisë për fëmijë që thithet herët, e që më vonë mësyn drejt rrafsheve të tjera më të larta gnoseologjike, në të cilat sendërohet shija për art dhe e cila bartet përherë si kapitall i paçmueshëm për ardhmërinë e njeriut”.¹¹

Natyrisht që letëria për fëmijë, megjithë veçoritë letrare si përmbajtja, tema, teksti, konteksti, rrëfimi, mesazhi etje., u dedikohet lexuesve të vegjël, por natyrisht, niveli letrar dhe artistik përkufizohet proporcionalisht me moshën e fëmijëve. Mosha është një faktor i rëndësishëm, sipas së cilës degëzohet materiali i letërsisë për fëmijë, si ai i nivelit didaktik ashtu edhe ai artistik letrar. Në këtë kontekst, prof. Salajdin Mehmeti bën një seleksionim të letërsisë për fëmijë sipas moshave të tyre, ku veprat e letërsisë i ndan në katër grupe kryesore¹²:

a) Veprat e letërsisë për fëmijë të moshës parashkollore, prej 6-7 vjeçare (fëmijët e kopshteve të fëmijëve);

b) Veprat e letërsisë për fëmijë për shkollarët e vegjël, prej moshës 6-7 vjeçare e deri në moshën 10-11 vjeçare (fëmijët e klasës I-IV të shkollës fillore);

c) Veprat e fëmijëve për adoleshentët, nga mosha 11-12 e deri në moshën 14-15 vjeçare (nxënësit e klasës V-VIII të shkollës fillore¹³) dhe

ç) Veprat letrare kushtuar moshës së rinisë së hershme, prej 14-15 vjeçare e deri në moshën 18 vjeçare.

Prandaj letërsia e tyre: librat e leximit, lektyrat shkollore, romanet për fëmijë etj., duhet të jenë të nivelit më të ngritur krahasuar me nivelin e letërsisë të fazës së lartëpërmendur, si nga arsenalit gjuhësor ashtu edhe nga ai teorik dhe gnoseologjik, sepse ”duhet thënë se misioni i letërsisë për fëmijë është shumë më i ndërlikuar dhe më i vështirë në arritjen e qëllimit, se sa ai i letërsisë së përgjithshme artistike”.¹⁴

¹¹ Nehas Sopaj, ”Letërsia për fëmijë”, Fq. 6, Fakulteti Filologjik ”Blazhe Koneski” - Shkup 2000.

¹² Salajdin Mehmeti, UP, SHLP, Përmbledhje punimesh, fq. 65, Prishtinë 1998

¹³ Sipas ligjit më të ri që doli nga Ministria e Arsimit për shkollat fillore, kësaj moshe i është shtuar edhe klasa IX.

¹⁴ Bedri Dedja, ”Burimet e letërsisë shqipe për fëmijë”. Fq. 10. Prishtinë, 1978.

1.2 LETËRSIA E PËRBOTSHME PËR FËMIJË

Nëse analizojmë pakëz letërsinë botërore për fëmijë, për analogji mund të themi se një kthesë e madhe u bë në vitin 1658 kur pedagogu çek, Jan Amos Komenski, botoi veprën e tij *“Bota në figura”* (*“Orbis pictus”*), e cila konsiderohet si vepra e parë e botuar për fëmijë. Vepra u botua në gjuhën latine. Në të janë përfshirë 150 figura të përcjella me tekstin përkatës. Vepra e Komenskit ka rëndësi historike, sepse shënon përpjekjen e parë për t’u shkruar një libër dedikuar fëmijëve. Me këtë rast nuk mund ta lëmë pa e përmendur edhe veprën e pedagogut dhe të teologut francez, Fransua Fenelon (1651-1715) me titull *“Përjetimet e Telemakut, djalit të Odiseut”*, e cila u botua në shumë gjuhë evropiane. Në vepër trajtohen pikëpamjet e Fenelonit lidhur me politikën dhe filozofinë e kohës. Kontribut të madh në zhvillimin e letërsisë për fëmijë dhanë edhe shumë shkrimtarë të tjerë, ndër të cilët dallohen Zhan dë La Fonten, njëri nga fabulistët më të mëdhenj të botës, fabulat e të cilit janë përkthyer në shumë gjuhë të botës, pastaj Charl Però, i cili me tregimet e veta, të punuara në mbështetje të motiveve popullore, mbetet edhe sot i dashur për fëmijë (është e njohur përralla e tij e bukur me titull *“Kësulkuqja”*). Letërsia angleze e kësaj kohe njihet me emrat e dy shkrimtarëve të mëdhenj: Daniel Defo, me romanin *“Robinson Kruzo”* dhe Xhonaton Suift, me romanin *“Udhëtimet e Guliverit”*. Sado që këto dy vepra nuk u shkruan posaçërisht për fëmijë, ato sot zënë vend ndër veprat që i lexojnë fëmijët dhe janë lektyrë e këndshme për ta. Letërsia për fëmijë u zhvillua sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XIX, i njohur si shekull i “shkencës dhe i teknikës”. Në këtë kohë ajo u pasurua me shumë shkrimtarë dhe vepra të njohura.

Gjatë kësaj kohe krijuan: Aleksandër Dymá, Zhyl Vern (krijoi romanin shkencor-fanatistik), Alfons Dode; Çarls Dikens. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX shkrimtarët më të njohur, që shkruan për fëmijë dhe të rinj, ishin: Robert Stivenson, Tomas Majn Rid, Herbert Uells, Ridjard Kipling, Mark Tuen, Xhim Feminor Kuper, Hariet Biçer Stou, Xhek London, Eliza Ozhenska, Henrik Senkjeviç, Bozhena Nemcova, Alojz Irasek, Edmond de Amiçis. Një kontribut të çmuar në fushën e letërsisë për fëmijë në shekullin XIX dhe XX dhanë edhe: Visarion Gligorijevç Bjelinski, Nikolaj G. Çernishevski, Nikollaj Dobroljubov, Pisarevi etj.

1.3 RILEXIMI DHE RIVLERËSIMI SHKENCOR I LETËRSISË PËR FËMIJË

Letërsia shqipe për fëmijë nuk është boshe. Ajo nis me librat e parë të letërsisë shqiptare për fëmijë, që u shkruan në fund të shekullit XVI dhe në fillim të shekullit XVII, kanë qenë libra me karakter mësimor (didaktik) – shkollor. Këta libra nuk ishin origjinalë, por të përkthyer nga gjuhët e huaja për mësim fetar të fëmijëve dhe të rriturve. Si libër i parë i shkruar posaçërisht për fëmijë, konsiderohet *Katekizmi* i Lekë Matrangës. *Katekizmi* i përkthyer është vepër e Atë Ladesmës (spanjol). Dorëshkrimi i librit ka 87 fletë, me 174 faqe, me një fletëkushtesë dhe një këngë të përshpirtshme, dhe mban datën 20 mars 1592. Qëllimi i Matrangës ishte mësimi i në gjithë shqipe i fëmijëve arbëreshë të fshatrave të Siqelisë. Këtë libër Matranga e përktheu nga dashuria që kishte për fëmijët, të cilën ai e shpreh me këto fjalë: “E unë derisa të jem gjallë nuk do të mungoj (siç kam vepruar gjatë gjithë kohës së kësaj kërshëndelle) të ndihmoj fëmijët dhe për hir të tyre të bëhem edhe vetë fëmijë që ata të përfitojnë sa më shumë...”.

Në shekullin XVIII, në jug të Shqipërisë, zhvillohet një aktivitet i gjerë arsimor dhe kulturor. Për zhvillimin e arsimit u hapën shkolla, në të cilat do të mësonin fëmijët shqiptarë. Nga kjo lindi edhe nevoja e hartimit të librave për nevojat e nxënësve që mësonin dhe ndiqnin këto shkolla. Autorë të ndryshëm hartuan libra shkollorë me karakter mësimor – fetar. Në mesin e këtyre autorëve, nga më të njohurit, që shkruan libra didaktikë – mësimorë, janë: Theodor Kavalioti, Dhanil Haxhiu dhe Kostë Berati. I pari, pra, Theodor Kavalioti, për nevojat e shkollave, shkroi librat: *Logjika*, *Fizika* dhe *Metafizika*. Por libri më i rëndësishëm i tij, që ka rëndësi për historinë e letërsisë së shkruar mësimore (didaktike) për fëmijë, është, padyshim, libri me titull “*Protopeiria*”(“*Mësimet fillestare* ose *Mësimet e para*”). Vepra paraqet interes të veçantë si abetare e parë e shkruar nga një autor yni. Edhe Dhanil Haxhiu për nevojat e shkollës së asaj kohe shkroi një libër për fëmijë me titull “*Eisagogiki didaskalia*”(“*Mësimet fillestare*”), libër i cili qe mjaft i përhapur në atë kohë si libër mësimi. Në gjysmën e dytë të shekulli XVIII një libër didaktik për nevojat e shkollës do të shkruajë edhe Konstantin Beratasi. Libri i tij u përdor në atë kohë.

Një fazë të re letërsia e shkruar shqipe për fëmijë e shënoi në shekullin XIX, kur u shkruan shumë vepra për fëmijë në gjuhën shqipe. Autorët, që u morën me krijime për fëmijë, i kushtuan një rëndësi të veçantë edukimit të brezit të ri, përhapjes së shkrimit dhe gjuhës shqipe,

hartimit të abetareve, teksteve shkollore, shkrimit të pjesëve letrare artistike, vjershave, tregimeve, përrallave artistike, fabulave etj. Si gjini letrare që zë vendin kryesor, është poezia lirike. Por, hapat e parë letërsia e shkruar shqipe për fëmijë do t'i bëjë në gjininë e fabulës, së cilës që më parë ia kishte siguruar vendin mësuesi, patrioti Theodor Haxhifilipi, i njohur me emrin Dhaskal Thodri, i cili kishte përkthyer disa fabula të fabulistit më të madh të lashtësisë greke, Ezopit. Ndër të parët që do të merret me lëvrimin e letërsisë shqiptare për fëmijë, qe atdhetari i shquar i lëvizjes sonë kombëtare, Naum Panajot Bredhi (Veqilharxhi, 1797-1846). Veqilharxhi është autor i abetares së parë shqipe. Abetarja e tij mban titullin “*Ëvetari*”, botuar në vitin 1844 dhe i ribotuar me plotësime në vitin 1845, me titull pak si të zgjeruar: “*Abetare e re për fëmijë që nisin të mësojnë për herë të parë, me copër të zgjedhura, a të mira e plot përfitime*”. Me *Abetaren* e tij dhe me idetë e shfaqura në të ai mund të konsiderohet si një nga nismëtarët e parë të letërsisë së shkruar shqiptare për fëmijë në periudhën e Rilindje Kombëtare Shqiptare. Në parathënien e *Abetares* drejtuar fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë, Veqilharxhi flet për nevojën e mësimi në gjuhën amtare, se gjuha amtare luan rol të rëndësishëm në zhvillimin mendor të fëmijës dhe ndikon në përvetësimin më të shpejtë të njohurive që jepen në shkollë. Sipas tij, padituria është burim i të gjitha të këqijave të një populli. Në parathënien e librit të tij ai shkriar: “*Sa kombe kanë mbetur në padije, u ngjasin gjithë robërve, duke punuar çdo ditë për begatinë e kombeve më të qytetëruara dhe më të fuqishëm; këta vetëm atëherë do të mund të dalin nga gjendje e turpshme e mjerimit të tyre, kur do të fillojnë të lërojnë gjuhën e tyre kombëtare...*”. Duke lexuar parathënien e librit, mësojmë se Veqilharxhi shqetësohej për fatin e fëmijëve të varfër, të cilët nuk kanë mundësi të mësojnë jashtë shtetit. Veqilharxhi kërkonte arsim për “*djemtë e skamësve*”, sepse “*vetëm kamësit mësojnë jashtë e shumica tjetër dergjet në errësirë të padijes*” etj. Një vend me rëndësi në historinë e letërsisë së shkruar shqiptare shkollore për fëmijë, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, zë edhe botimi i Abetares së gjuhës shqipe e Shoqërisë së Stambollit, botuar në Konstantinopojë, më 1879, nga Sami Frashëri, Jani Vreto dhe Koto Hoxhi. Abetarja e hartuar nga këta autorë dhe e botuar nga shoqëria e stambollit, ishte një përmbledhje tekstesh elementare për shkollën fillore. Në Abetare është përfshirë shkrimi: *Gjuha shqipe* e Sami Frashërit, pastaj “*Shqypnija e shqyptarët*” e Vaso Pashës etj.

Mbi bazat e kësaj letërsie lindi dhe u zhvillua më vonë letërsia artistike shqiptare për fëmijë, bazat e së cilës, në gjysmën e shekullit XIX, i vunë: Kristoforidhi, Naimi, Samiu, Çajupi, Negovani, Gjerasim Qiriazhi etj. Një fazë të re letërsia shqiptare për fëmijë e shënoi në vitet e

fundit të Rilindjes Kombëtare dhe në periudhën pas shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar. Autorët që shkruan në këtë kohë janë: Luigj Gurakuqi, Anton Xanoni, Hil Mosi, Ilo Mitkë Qafëzezi, Milto Sotir Gurra, Vasil Xhaçka etj. Ky i fundit botoi revistën e parë me titull “*Vatra e rinisë*”(1933-1939). Gjatë Luftës së Dytë Botërore lindi letërsia e re shqiptare për fëmijë, e cila që vazhdim i letërsisë paraprase për fëmijë e mbështetur në burimet popullore dhe në krijimet letrare për fëmijë të rilindësve dhe vazhdoi me autorët e rinj të viteve '30 e të fillimeve të viteve '40, e deri në ditët tona. Një zhvillim të hovshëm mori letërsia për fëmijë dhe të rinj pas çlirimit të Shqipërisë me botimin e revistave dhe të gazetave për fëmijë. Zhvillimin e saj e dëshmojnë botimet e shumta kushtuar fëmijëve, gazetatat dhe revistat e ndryshme, pastaj emisionet në radio dhe televizion. Në letërsinë shqiptare për fëmijë thuajse janë lëvruar të gjitha gjinitë letrare, si poezia lirike, fabula, poema, tregimi dhe përralla artistike, novela, romani drama dhe pjesët për kukulla. Përveç këtyre gjinive dhe llojeve poetike, u zhvillua edhe kritika letrare. Në grupin e gjeneratës së parë bëjnë pjesë Hivzi Sulejmani, Mark Krasniqi, Rexhep Hoxha, Mehmedali Hoxha, Abdylazis Islami, pastaj vijnë shkrimtarët Ali Huruglica, Qamil Batalli, Rifat Kukaj, Vehbi Kikaj, Fejzi Bojku, Hajro Ulqinaku etj.. Gjeneratës së re të krijuesve për fëmijë i përkasin shkrimtarët Zejnullah Halili, Agim Deva, Arif Demolli, Ymer Elshani, Gani Xhafolli, Zymber Elshani e shumë të tjerë që janë paraqitur në kohën e fundit.

1.4 POEZIA PËR FËMIJË

Abdylazis Islami përfshihet së bashku me poetë të tillë me emër e individualitet si: Rahman Dedaj, Beqir Musliu, Muhamet Kërveshi etj. 1. Kritiku vinte në dukje se: ”Në vargjet e Abdylazis Islamit, jetojnë, në ritmin e frymëmarrjes së plotë, poet i cili ka thyer logjikën e vargut tradicional të poezisë shqipe dhe poeti që dëshiron të ruajë dhe e ruan një logjikë të tillë.”¹⁵

¹⁵ Kadriu Zeqir,, “ Dekada e heshtjes dhe dhembjes krenare Abdylazis Islami; Në jetë i qetë në shpirt tërmet! “ Konferenca IX Shkencore Ndërkombëtare me temë “Veprimtaria letrare e Abdylazis Islamit dhe Murat Isakut” (me rastin e 10 vjetorit të ndarjes nga jeta), mbajtur më 20 nëntor 2015 në UEJL, Tetovë, f. 15

¹⁵ Po aty, 14-16

Natyrë dhe temperament i poetit qënë tejet emocional, por me aftësitë përthithëse shumë më të mëdha për nga ndjeshmëria dhe vetëvetimi e mbanin shpirtin e tij përherë të trazuar, të paqetë, të dallgëzuar ose siç e ka thënë bukur Maksut Shehu në një ese të tij kushtuar poetit, ai është:” Në jetë i qetë, në vargje tërmet...”Përherë më hidhte dilema: A thua sa shpirtëra janë vendosur në një trup të njomë? Bindja e përhershme: Abdylazisi ka lindur për poezi.”Dhe mëtej: ai vihet të shkruajë vetëm atëherë kur heton se i pëlçet kraharori prej ardhjes së vargjeve, si shkundullimë e puplës mes dhjetë furtunash që fryjnë prej katër anësh të botës, edhe prej thellësive nga burojnë vullkanet”...i mendueshëm për thellësinë e ëndrrave dhe gjithmonë i buzëqeshur jam takuar me poetin që është rrokullisur prej lartësive në rrafsh që të ecë me hap me të gjithë njerëzit e mëdhenj e kanë merituar jetën ta jetojnë e të hyjnë në ardhmëri”.¹⁶

Në tri poemat me titujt : Pella(z)ngonia , Pollogu dhe Ilirijada, poeti trajton tema nga historia e lashtë ilire , para ilire e deri në kohën që lidhen me ngjarje të shumta të hapësirës së Maqedonisë së sotme, të emëruar edhe si Iliridë. Vargjet poetike plot me histori dhe zhvillimet në dëm të shqiptarëve brenda asaj historie, si duket ,sa më shumë i afrohen kohës sonë, më tepër angazhohen për njohjen e vlerave të reja të atij realiteti. Derisa poetët klasikë kanë besuar se jeta duhet zbuluar,e poetët modernë mendojnë se jetën duhet ndryshuar (I. Veliu, Parathënia, f.8), autori i poemave që po i trajtojmë mundohet që këtë rrugëtim të kombit nëpër histori, edhe ta njohë edhe ta ndryshojë .Kërkimin e poetit nëpër historinë e largët, madje të pandriçuar mirë edhe nga vetë historia, e kuptojmë më tepër si dëshirë të tij, që atë ta sjellë edhe me petkun e artit letrar. Në këtë drejtim ai pati sukses, pikërisht se ishte i formuar dhe i edukuar në frymën e historisë së re të kombit, traditës, dashurisë dhe të flijimit për të.¹⁷

Poezia e Abdylazis Islami është provokim si për lexuesin ashtu dhe për vetë autorin. Personazh i tij lirik është dëshmitar dhe njëkohësisht interpretues i të gjitha dilemave, lindjeve dhe vdekjeve, dhe shpresave në horizont. Heroi lirik i poezisë së tij është kërkim të një rruge të

¹⁶ Kadriu Zeqir,, “ Dekada e heshtjes dhe dhembjes krenare Abdylazis Islami; Në jetë i qetë në shpirt tërmet! “ Konferenca IX Shkencore Ndërkombëtare me temë “Veprimtaria letrare e Abdylazis Islamit dhe Murat Isakut” (me rastin e 10 vjetorit të ndarjes nga jeta), mbajtur më 20 nëntor 2015 në UEJL, Tetovë, f. 18

¹⁷ Vebi Bexheti UEJL, Tetovë Kronika historike në tri poemat e Abdylazis Islamit, Konferenca IX Shkencore Ndërkombëtare me temë “Veprimtaria letrare e Abdylazis Islamit dhe Murat Isakut” (me rastin e 10 vjetorit të ndarjes nga jeta), mbajtur më 20 nëntor 2015 në UEJL, Tetovë, f. 22

re, e cila atij do t'ia sigurojë atë minimumin e krenarisë, pa të cilën dozë të domosdoshme, njeriu në dyluftim me valët e jetës do të dilte përherë i mundur.¹⁸

1.5 PROZA PËR FËMIJË – tregimi dhe romani

Edhe në prozën e tij siç është p.sh. romani për të rinj “KRIMI NË TEMPULL” , elementi i lashtësisë, përbën narracionin e romanit, ku vihet në pah pushtimi romak i vendeve ilire, qëndresa e popullatës vendase, imponimi i fesë nga ana e pushtuesit të trojeve të Ilirisë së Epërme por, edhe tradhëtia. Shkrimtari i kujton lexuesit përmes tregimit me titull, ”FIGURAT E MUREVE TË SHENJTA”, se të parët e tij faleshin dhe luteshin te këto mure, të cilët i njihnin për të shenjta që nga kohët parahistorike, dhe e festonin festën pagane atë të “Ditës së Luleve”. Ai e përcakton ngjarjen në lokalitetet, jep toponimet e fshatrave si: Pirro, Rako, Voc, Gardhishtë, siç thotë dhe vetë shkrimtari në tregimin “HIJET E KRYENGRITJES ILIRE”, tumat ilire, kalorësin e bronzit etj. Te tregimi “VULA E TURPIT” shkrimtari A. Islami na jep artefaktin parahistorik, me oronimin apo emërmalin: “Mali Skard dukej se i pranonte me zemër të hapur”, ose “Te varri i Ulkinës, në një rasë shkruan: “ ULKINA (28) E BIJA E GURMADHIT DHE E ERËNDËS NGA VOCI SI DHE GRUAJA E GJIN PIRROS NGA PIROJA, NËNA E TEFTËS (8) DHE E ARNITIT(6) VDIQ HEROI..¹⁹

Romani për fëmijë ka rëndësi të madhe në formimin e mendimeve dhe aftësive shprehëse të fëmijëve, ai gjithashtu është një thesar për pasurimin e fëmijëve me njohuritë më të ndryshme, nga bota e të rriturve, bota bimore dhe ajo shtazore dhe për shumë gjëra të tjera që atë e rrethojnë.

Romani i ndihmon fëmijës që të vërë raporte me të tjerët, e ndërton si individ shoqëror dhe i ndihmon për të depërtuar në shoqëri. Edhe pse vetë akti i leximit është i mëvetësishëm, meqë procesi i leximit është një akt artistik për kënaqësi individuale, nga njëra anë, por edhe për ta përkujtuar lexuesin e vogël se megjithatë, nuk është i vetëm me botën e tij, por duhet të krijojë

¹⁸ Ibrahim Veliu, Vepra nr4, Abdylazis Islami, Vatra, Shkup, 2006, f. 13

¹⁹ Kasam SHAQIRVELA Tetovë / Maqedoni Elementi i lashtësisë në krijimtarinë e Abdylazis Islamit , Konferenca IX Shkencore Ndërkombëtare me temë “Veprimtaria letrare e Abdylazis Islamit dhe Murat Isakut” (me rastin e 10 vjetorit të ndarjes nga jeta), mbajtur më 20 nëntor 2015 në UEJL, Tetovë, f. 72

pirje për t'i përfillur edhe kërkesat e botërave që e rrethojnë nga ana tjetër, që paraqet realizimin e një segmenti bipolar, intelektual dhe artistik të romanit të tij. "Kërkesat e përgjithshme të artit letrar, siç janë figurat artistike, subjekti, fabula, gjuha artistike, karakteret, uniteti i formës me përmbajtjen, kompozicioni, etj. të një veprë letrare për fëmijë, duhet të harmonizohen këtu edhe me kërkesat pedagogjike; të ndërtohen mbi bazë pedagogjike dhe psikologjike".²⁰

Romani, fëmijës gjithashtu i ndihmon në aspektin e të kuptuarit të botës së jashtme dhe raporteve të ndryshme që i zbulon në çdo moment të cilat i akumulon si perceptime që ia kompletojnë vizionet e përfituara në rrethin familjar, në rrugë, në shkollë dhe gjetiu. Pastaj ato t'i gjykojë dhe të adaptohet në sistemet e drejta dhe pozitive jo vetëm në rrethe të përmendura, por kudo që të gjendet ai. Si shembull më të mirë për ilustrim vlen të përmendet romani i Rexhep Hoxhës "Ermali" i cili akoma si fëmijë dinte të vlerësonte dhe të diferenconte patriotizmin e vërtetë të arsimit të tij, Bardhi, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër patriotizmin e rrejshëm të personazhit të Himës me veshjen kombëtare dhe me plis të bardhë mbi kokë. Raporti i këtij personazhi rrëfhet me disa akte ironike që në të vërtetë shpaloset ana tragjike e realitetit tonë të hidhur, me ç'rast "fëmijët i njohin me panorama të gjera të jetës shoqërore, pasqyrohen plagët e shoqërisë, goditen veset, klasat sunduese parazite, rendi social, etj"²¹. Gjithashtu kriteri i fantazisë për fëmijë, i mundëson të krijojë kreativitetin dhe të vërë raporte me botën e tij vizuale dhe paraqet një armë që lufton për lirinë e vet fëmijërore. Por kjo varet shumë nga mosha dhe "njohja e cilësive psikologjike që jep mundësinë, gjithashtu, që shkrimtari të dijë e të zgjedhë metodat dhe mënyrat e tregimit dhe të krijimit të figurave artistike në veprën e vet,- metoda këto që mund t'i përshtaten njërës ose tjetrës moshë".²² Por "si personazhet përrallore, ashtu edhe personazhet e fantastikës, janë pjellë e imagjinatës së shkrimtarit që dalin si modifikim i dukurive të realitetit objektiv, kështu që ato në vetëdijen e lexuesit koshient janë personazhe ireale me veprime dhe bëma që janë hiperbolizime të shkrimtarit".²³

Ngjarjet dramatike në roman, dhe në çdo tregim tjetër dramatik, aktivizojnë ndjeshmërinë (emotivitetin), që është një nga aspektet themelore që përcaktojnë personalitetin e fëmijës. Ndjeshmëria, si karakteristikë psikologjike në shtresat më të thella të personalitetit, varësisht nga

²⁰ Bedri Dedja, "Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë", fq. 138, Tiranë, 1971

²¹ Bedri Dedja, "Burimet e letërsisë shqipe për fëmijë". Fq. 26. Prishtinë, 1978.

²² Bedri Dedja, "Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë", fq. 140, 141. Tiranë, 1971

²³ Nehas Sopaj, "Letërsia për fëmijë". Fq. 73. Shkup, 2000.

zhvillimi i ngjarjes, shkakton reaksione emocionale, si p.sh. hidhërimin, frikën, dëshirën, gëzimin, ankthin, fajin, turpin etj. Romanet me tematika të ndryshme, janë një mënyrë e angazhimit të autorëve tanë për fëmijë, që efektet e ndryshme psikologjike, gjithsesi ato pozitive, t'i ngërthejnë në botën e personazheve, që te fëmijët jo vetëm të zgjojnë emocione pozitive, por edhe të nxisin forcën e intelektit, si p.sh; të njohjes së raportit ndërmjet shkakut dhe pasojës në vetë ngjarjen. "Literatura në këtë domen tregon shumë pajtueshmëri me përvojat praktike të të gjithë atyre që kanë edukuar fëmijë".²⁴

Në romanin e Abdylaziz Islamit "Vajza e panjohur", "për realizimin e ideve të tij, autori përdor forma të ndryshme të të rrëfyerit. Forma që zotëron në roman është forma e vetës së parë dhe këtë rol ai ia beson Gencit, i cili rrëfen në vetën e parë, rrëfen në emrin e vet dhe rrëfen për atë që ndjen, për atë që e brengos dhe e shqetëson. Rrëfimi i tij është lirik dhe i drejtpërdrejtë. Ai rrëfen për vajzën e panjohur, për dashurinë që do t'ia shfaqë ajo, për shenjat që do t'ia japë, për rrugëtimin e tij të mundimshëm për në **Bakërinë**, për takimin e tij me vajzën e panjohur, për burgun, për kthimin në vendlindje etj. Në gjithë këtë punë do ta ndihmojë xhaxhai i tij Luli, portretin e të cilit autori e ka dhënë më së miri. Luli është një individualitet më vete, i pajisur me një përvojë të madhe jetësore. Është malësor tipik, njeri i urtë dhe i matur në jetë, njeri me vullnet të fortë dhe i vendosur në situata kritike në jetë. Ai është edhe rapsod i mirë i këngëve të *rralla* popullore. Është njeri i fjalës dhe i veprimit, njeri i vendosur dhe optimist, ai është edhe pleqnar i dëgjuar jo vetëm në fshatin Kreshnikajë, por edhe më gjerë. Luli është njohës i mirë i turqishtes (që e kishte mësuar si bari dhensh në Traki). Përmes kësaj figure autori shpreh pikëpamjet e tij mbi jetën, qëndrimet dhe përcaktimet e tij ideore. Preokupim kryesor i tij është ta shpëtojë Gencin nga depresioni shpirtëror, nga shqetësimet para takimit të tij me Djellinën. Për t'ia lehtësuar barrën Gencit, i shpjegon përralla si një psikolog i mirë...",²⁵ dhe të gjitha këto te fëmijët paraqesin rrëfime interesante dhe zgjojnë kureshtjet e tyre për njohuri të tjera nga rrëfimet e romanit.

Është karakteristike që te romani për fëmijë, rrëfimi gjithnjë shtjellohet përmes personazhit kryesor, apo rreth e përqark tij, dhe në këtë kontekst Bedri Dedja në veprën e tij, shpreh një mendim të Makarenkos i cili thotë se "personaliteti i heroit të veprës nuk ka rëndësi

²⁴ Stanisha Nikoliq, "Bota e psikës fëmijërore". Fq. 55. Shkup, 2006.

²⁵ Salajdin Mehmeti, "Nga letërsia shqipe për fëmijë". (Dorëshkrim)

për fëmijët, sepse është i papërsëritshëm dhe i rrallë, por më tepër gjykohet prej tyre në bazë të veprimit, që kryen dhe si pjesëtar i ngjarjes. Sado interesante që të jetë figura e një tipi në veprën për fëmijë, lexuesi i vogël do ta çmojë atë në bazë të veprimit që kryen, pa marrë parasysh asgjë tjetër”.²⁶

1.5 DRAMA PËR FËMIJË

Drama për fëmijë është gjini letrare ku tregohet ndonjë ngjarje përmes veprimit të personazheve në skenën teatrore para shikuesve. Thelbin e dramës e përbën konflikti dramatik i cili shpie në tensionin e veprimit dramatik, në aksion dhe në reaksion të forcave kundërshtare. Veçori tjetër e dramës është dialogu, përmes të cilit shprehet e tërë ajo që thuhet në veprën dramatike. Autori i le personazhet e tij të flasin e të veprojnë sipas karaktereve të tyre. Vepra dramatike shkruhet jo vetëm për t’u lexuar, por edhe për t’u shfaqur në skenën teatrore. Jetën e saj të veçantë vepra dramatike e bën në skenë. Drama ka specifikat e saj që e dallojnë nga gjinitë e tjera letrare. Në dramë dallojmë: ekspozicionin, thurjen, kulminacionin, peripecinë dhe shthurjen e veprimit. Ekspozicioni jepet rëndom në fillim të dramës në bisedën midis dy a më shumë personazheve, të cilat na njoftojnë mbi ngjarjet që do të zhvillohen në dramë. Në dramën antike këtë e bënte një aktor para fillimit të shfaqjes në skenë, i cili fliste mbi personazhet, thurjen dhe shthurjen e veprimit. Kjo pjesë e dramës quhet prolog. Në dramën bashkëkohore këtë e ka zëvendësuar lista teatrore ose afishja ku shënohen emrat e personazheve, afëria e tyre gjinore, raportet midis tyre etj. Thurja është ajo pjesë e dramës kur në aksion paraqitet hero i kryesor.

Kulminacioni paraqet momentin më tronditës të konfliktit, kur ekziston mundësia e më shumë zgjidhjeve të veprimit. Peripecia paraqet momentin kur bëhet kthesë në veprimin dramatik në drejtimin e caktuar. Shthurja paraqet zgjidhjen e konfliktit.

²⁶ Bedri Dedja, "Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë". Fq. 136. Tiranë, 1971.

1.5.1 DRAMA SHQIPE PËR FËMIJË, AUTORË DHE VEPRA

Vështrim diakronik mbi dramën shqipe në sistemin letrar shqiptar duhet të nisë si një studim më përgjithësues. Fjala *dramaturgji* është një term i gjerë dhe me shumë kuptime. Fjalorët e termave letrarë dhe itnerpretues në të shumtën e herëve përmbledhin në termin dramaturgji; tekstin teatral, të shkruarit, poetikën dhe vënien e tij në skenë. Dramë – a (gr. δράμα – vepër, veprim). 1. Lit. Gjini e letërsisë artistike që e pasqyron jetën përmes veprimit skenik të personazheve dhe të dialogëve e të monologëve të tyre; vepër letrare e këtij lloji; shfaqja e kësaj veprë në skenë; 2. Ngjarje e rëndë a tronditëse, ngjarje dramatike; fatkeqësi që shkakton vuajtje a dhembje të mëdha shpirtërore”.²⁷

Drama është një nga gjinitë kryesore të letërsisë artistike. Tekstet e shkruara për teatër i quajmë dramë. Ashtu si përralla, tregimi, romani edhe drama ka një ngjarje kryesore. Në kohërat e hershme mbizotëronte shkrimi i dramës në vargje, por sot ajo shkruhet në prozë, pasi proza i ofron asaj më shumë mundësi shprehëse se sa poezia. Tematika e dramës është e afërt me atë të prozës (tema historike, tema shoqerore, tema filozofike etj.). Në varësi të tematikës kemi disa lloje dramash: drama historike, drama shoqërore etj. Konfliktet e dramës janë konflikte të zakonshme që ndodhin në jetën e përditshme njerëzore.

Të gjitha këto anë janë të lidhura me procesin e shkrimit të tekstit dhe paraqitjes së këtij teksit në skenë. Qasja jonë do të interesohet për tekstin dramatik, atë të shkruarin jo atë të skenës.. Në kontekstin e studimeve letrare, termi dramaturgji ka vazhduar të përdoret për të përcaktuar artin e krijimit apo të kompozimit dramatik, ashtu siç na jepet në tekstet e dramave. Ne do të ndanim nga ky term analizën dramaturgjike, që është praktika kritike, e cila konsiston në përshkrimin dhe vlerësimin e efekteve të këtij arti dhe në përdorimin e teorisë dramaturgjike, e cila na jep instrumentet e nevojshme për këtë praktikë. Struktura diakronike e gjinisë dramatike në sistemin letrar të letërsisë shqipe, nuk mund ta mënjanojë nevojën që kishte për institucionin e teatrit. Hapësira e vogël që zë drama si prodhim letrar brenda sistemit letrar shqiptar në fazat e tij fillestare, ka të bëjë me faktin se prodhimi kryesor letrar ishte i lidhur ngushtë me poezinë. Struktura e sistemit tonë letrar ka pasur si dominante poezinë qoftë në krijimtarinë gojore folklorike, qoftë përta i përket krijimtarisë letrare të kultivuar.

²⁷ Mikel Ndreca, Fjalor Fjalësh dhe shprehjesh të huaja, RB “Rilindja”, Prishtinë 2000, f. 169

Drama shqipe, në diakroni dhe sinkroni me atë nivel letrar që paraqitet, është lëvruar pa ndërprerje. Sipas studiuesit Sabri Hamiti, “...drama është forma më e kanonizuar letrare, madje formë konservative dhe është e lidhur me teatrin si medium, i cili është i kushtëzuar nga niveli i institucionalizimit të kulturës së një mjedisi. Në parim, forma dramatike nuk shkruhet për t’u lexuar, por për t’u luajtur. Vetë këto venerime dëshmojnë pse drama si formë paraqitet vonë në letërsinë shqipe dhe pse variantet e saj nuk janë të mëdha”²⁸

Drama në letërsinë tonë për fëmijë nuk është lëvruar sa duhet. Ajo është shkruar nga mësuesit e shkollave që drejtonin grupet teatrore ose që edhe luanin vetë në to. Ndër të parët që u morën me hartimin e pjesëve teatrore për fëmijë përmenden Koto Hoxhi, Gjerasim Qiriazhi, Petro Nino Luarasi etj. Pjesët e shkruara nga këta mësues kishin karakter mësimor dhe përmbajtje atdhetare. Pjesët që i përgatitnin dhe i shfaqnin këta me rastin e festave shkollore quheshin “bashkëfjalime”.

Letërsia kanonike, ajo që përbënte bërthamën e sistemit letrar shqiptar, ka në përbërjen e saj krijimtarinë apo produktin letrar të tri brezave ose të dy etapave të letërsisë së romantizmit shqiptar. Rexhep Qosja kur trajton romantizmin në librin “Historia e letërsisë shqipe” shkruan: “Për historinë e letërsisë shqipe, krijuesit më të rëndësishëm të etapës së parë janë: Naum Veqilharxhi, Jeronim de Rada, Françesk Anton Santori, Thimi Mitko, Jani Vreto, Pashko Vasa, Gavril Dara i Riu dhe Kostandin Kristoforidhi, kurse të etapës së dytë: Zef Serembe, Naim Frashëri, Ndue Bytyçi, Sami Frashëri, Filip Shiroka, Zef Skiroi dhe Ndre Mjeda. Shkrimtarët siç janë Anton Xanoni, Ndoc Nikaj, Çajupi, Asdreni, Gjergj Fishta, Mihal Grameno, Papa Kristo Negovani, Luigi Gurakuqi dhe Hilë Mosi, me veçoritë ideo-stilistike të krijimtarisë së tyre, cili më pak e cili më shumë, e tejkalojnë poetikën romantike dhe ndërtojnë premisat ideostilistike të periudhës së pasme, në të cilën do të bashkëzërojnë apo të ecin krahas njëratjetrës prirje romantike, realiste, neoklasiciste dhe simboliste.”²⁹

Shkaqet e moszhvillimit të kësaj gjinie letrare për fëmijë janë mungesa e një teatri për moshat më të vogla, që do të ishte një stimulim për shkrimin e dramave për fëmijë, e cila hapat e parë të saj i bëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ajo (drama) zë fill me dramat “Qemal Stafa”, “4 shkurti”, “Pika e kalimit” të Bedri Dedjes. Drama për fëmijë kanë shkruar Kolë Jakova, Haki

²⁸ Sabri: Hamiti, Tematologjia, Botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2005, f. 85.

²⁹ Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I, Tiranë, 2000, f. 427.

Stërmilli, Ismail Kadare, Tonin Shiroka, Odhise Grillo, Skënder Hasko, Gaqo Bushaka, Adelina Mamaqi, Abdyl Bunjaku, Nuhi Islami, Rizah Sheqiri, R. Zejneli, R. Kukaj, Q. Batalli etj.

Kritiku i teatrit Josif Papagjoni nënvizon: “Dramaturgjia pas viteve ‘90 në Shqipëri, e çliruar nga kufizimet estetike doktrinare, bën përpjekje për të aplikuar në forma dhe tipa të larme, si në konceptimin e objektit a lëndës dramatike, ashtu edhe, sidomos, në riprodhimin artistik të saj përmes strukturave moderne. dramash, si: “Çmurosja”, “Pse” (S. Fanko), “Tri mendje në ankand”, “Para semaforit”, “Shpirti i ujkut” (F. Hysi), “Tiranozauri”, “Muzeu” (K. Trebeshina), “Ftesë për darkë”, “Utopos”, “Tri këngë dashurie” (S. Çapaliku), “Parfumeria”, “Katër epoletat” (A. Mulliqi), “Vizita e fundit”, “Ishulli i Shitenit” (A. Brahusha), “Hijesina” (N. Islami), etj., bëhen më aktive elemente të tilla, si: tjetërsimi, alegoria, simbolika, metaforizimi i fakteve dhe i marrëdhënieve, shumësia e planeve të shikimit brenda të njëjtit fakt apo personazh, konfuzioni i qëllimshëm, konvencionalizmi dhe shpërfytyrimi i ndjeshëm i kohës dhe i hapësirës dramatike, sajimet dhe paradokset, bashkëshoqërimet ideo-figurative, shtresimet e njëpasnjëshme të semantikës së fjalës në dialog, inverset dhe përthyerjet kontrapunktuale, ciklet e veprimeve që hapen ose mbyllen, etj. Shpesh komunikimi me lexuesin vështirësohet enkas ose ndërlikohet me rrafshet e njëpasnjëshme kuptimore që u jepet pohimeve dhe sjelljes së personazheve, në kohë e vende të ndryshme”³⁰

Kontribut të veçantë në zhvillimin e dramës bashkëkohore kanë dhënë edhe revistat **Pionieri**, **Gëzimi**, pastaj shtëpitë botuese, televizioni, teatrot profesioniste etj. Çështja e shkrimit të dramave duhet të jetë preokupim i përhershëm i shkrimtarëve tanë që merren me krijimtarinë për fëmijë. Ndërsa në letërsinë shqipe që krijohet në Maqedoni në dramë për fëmijë në nivel kombëtare ka shkëlqeyr Abdylazis Islami.

³⁰ Josif: Papagjoni, Sprova të modernizmit në rrjedhat e fundme të dramës shqipe, Aktet e seminarit shkencor, Tiranë, 2004, f. 150.

KAPITULLI I DYTË

2.1 PORTRETI LETRAR I ABDYLAZIS ISLAMIT

Abdylazis Islami ka lindur në fshatin Gajre të Tetovës. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, kurse gjysmëmaturën në Tetovë. Shkollën normale dhe Akademinë Pedagogjike (gjuhë dhe letërsi shqipe) i ka kryer në Shkup. Punoi mësues, këshilltar pedagogjik, gazetar e redaktor i emisioneve për kulturë dhe arsim në gjuhën shqipe të Radio-Shkupit derisa u pensionua.

Abdulazis Islami është poeti, shkrimtari dhe dramaturgu pa të cilin letërsia shqipe që krijohet në Maqedoni do të ishte e mangët. Ai bashkë me Murat Isakun, janë dy doajenët, të cilët përmes vlerave i sollën nderin më të madh të letërsisë shqipe. “Ai ka ecur paralelisht deri në momentet e fundit të jetës së tij. Herë është dhe i çuditshëm, jo vetëm për nga forma e të shkruarit, jo vetëm nga forma morale, fizike, që krijoi gjithë ato vepra, por edhe me atë karakteristike se si i përballoi të gjitha sfidat e jetës, të cilat i pati goxha të rënda, dhe përsëri nuk lëshoi lapsin nga dora”.³¹

Abdulazis Islami ishte krijues me një personalitet dhe integritet të fuqishëm shpirtëror, tek i cili refleksi i brendshëm, ai krijues dhe dukja e jashtme kishin një burim frymëzues të veçantë. Bota intelektuale e tij është vetë bota e kulturës njerëzore, historisë dhe letërsisë. Madje u quajt dhe “Enciklopedi e gjallë” emër i madh që shndërroi në fushën e letërsisë e posaçërisht atë të letërsisë për fëmijë. Figura e fëmijës është maktrotema e krijimit. Lexuesi fëmijë ndjen kënaqësi kur takohet me krijimet për to, rrok ndjeshmërinë e tyre, prek sensin e veçantë të zbavitjes dhe lojës. Ai përmes letërsisë diti të përcjellë edukatën për fëmijët, madje dhe të krijojë frymëzim për të shkruar në moshë të re letërsinë e tyre, të shkruajë poezi për fëmijë. Siç thoshte Odise Grillo, “për lexuesit e vegjël dhe të mëdhenj i këndon zemrën në gjuhën shqipe dhe po krijon vepra të reja”.³²

³¹ Ejup Ajdini, Letërsia shqipe për fëmijë në Maqedoni, Tetovë, 2008. F. 25

³² Odhise Grillo, Shkrimtarë shqiptarë për fëmijë, Tiranë, 1997, f. 94

Në raport me poezinë thuhet se insiston në “modernizim të poezisë dhe e njëjta të dallohet nga ritualitetet e mëvetësishme artistike.”³³ Synonte në “gjykim të vetin individual”.³⁴ Maksut Shehu në një shkrim të tij në gazetën Flaka shkruan se Abdulazisi, është “në jetë i qetë në vargje tërmet”.³⁵

*“Të lexosh do të thotë ta dëshirosh veprën, do të thotë të duash të jesh vepra, do të thotë ta refuzosh ta dyfishosh veprën jashtë çdo të folurit tjetër pos të folurit të vetë veprës (...) Të kalosh nga leximi në kritikë do të thotë ta ndryshosh dëshirën, do të thotë ta dëshirosh jo më veprën, por ligjërimin e vet (...) Sa shkrimtarë kanë shkruar vetëm se kanë lexuar. Sa kritikë kanë lexuar vetëm për të shkruar”*³⁶.

Veprimtaria letrare e poetit, shkrimtarit dhe dramaturgut për fëmijë Abdyazis Islami shtrihet në hapësirën kohore të gjysmës së dytë të shekullit XX. Gjatë kësaj kohe të shkrimeve, ndër më produktivet të letërsisë shqipe të Maqedonisë, mund të themi se që nga vitet e pesëdhjeta, krijimtaria e tij si në poezi ashtu edhe në prozë e dramë e tij modeste, ka qenë e pranishme, pa ndërprerje, në letërsinë shqipe dhe lexuesin e saj në Maqedoni, në Kosovë dhe shumë pakëz në Shqipëri. Madje përfaqësimi i saj në shtetet tona simotra ka qenë simbolike, një prani vetëm të dashamirët e letërsisë dhe miqtë e poetit dhe dramaturgut.

Bota krijuese e Abdyazis Islamit i ngjan një mozaiku të nderuar më shumë përvoja dhe dyer të lëna hapur për studime më të thelluara. Në të hyhet nëpërmjet rrugës e shtigjeve të llojllojta. Semiologu i madh i kohës, Umberto Eco, duke shtruar probleme rreth *autorit* dhe *interpretuesit* të tij, shtron një intencë që zhvillohet si përsiatje, kur thekson “*dialektikën midis të drejtës së teksteve dhe të drejtës së interpretuesve të tij*”. Unë këtu synoj këtë të fundit, gjithnjë me qëllimin e evidentimit të disa elementeve tekstuale, në synim të *literaritetit* në tekste të caktuara të korpusi i krijimtarisë së tij, e posaçërisht të dramës e tij modeste, të cilat deri më sot nuk ka ndonjë studim të veçantë në nivel magjistrature dhe doktorate ose ndonjë monografia të përveçme. Referencë mbetet libri i profesori Zeqir Kadriut që shënon një tekst të vetmuar në

³³ Rexhep Qosja, *Kritika letrare*, Prishtinë, 1969, f. 57

³⁴ Ramadan Musliu, *Rrëfimi poetik*, Prishtinë, 1990, f.41

³⁵ Maksut Shehu, “Flaka”, *Shkup*, 1990, f.17

³⁶ Rolan Bart, *Aventura Semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008, f. 208

shkencë për krijimtarinë e tij. Ka recensione, studime sipërfaqesore, por dramat e tij mbeten ta pastudiuara deri më tani.

Kur një studiuese e re merr të analizojë dramat e Abdyazis Islamit si njërin nga shkrimtarët më të admiruar dhe kur atë nuk ka mundësi ta takojë, ndodh që të ngelë i zhgënjyer nga studimi i tij. Jo nga shkaku se shkrimi mund t'i mungojë ndonjë fusnotë apo se vuan nga jo-profesionalizmi metodologjik - shkencor, por se nuk arrin të zbulojë të fshehtën e shenjtë të fshehur në botën delikate të personazhi dramaturgjik, kuptimin bazë të diskursit të tij, parimin lëvizës që ka letërsia dramaturgjike e tij që nuk e lë personazhin në një vend, por e shndërron në *aktant* dhe gjestin e tij në veprim. Ky dramaturg i njohur për letërsinë tonë është një ndër penat më të fuqishme të letërsisë shqipe në Maqedoni, një poet dhe dramaturg brilant, me plot talent, sens e dije poetike të formuara me kulturë të lartë leximi dhe njohës i madh i botës së fëmijëve.

Jonathan Culler thoshte se: *një shpirt i natyrës, një Muzë, një dashnore, një Zot, një përsiatje e mishëruar, ose një objekt natyre* janë të mjaftueshme për të ngjitur atë mekanizmin delikat të shkrimtarit. Perceptimet poetike të dramave të Abdyazis Islamit janë klithma intelektuale, fjalët janë goditëse, ritmi i tekstit është dramatik dhe shërben për të funksionalizuar *katharsisin letrar aristotelian*, sidomos në dramat me trajta *vetë-rrëfimi*, *lirikat afirmative* dhe *persiatëse* ku shkrimtari bashkëbisedon me qeniet e dashura, me muzat për rreth tij, me Zotin e Natyrën u lë testament *librin e lirisë* dhe *të identitetit*, të shkruar me simbolet e vetëflimit, me ironinë e hidhur, me urtinë frazeologjike, me simbolet e dashurisë...

Letërsia shqipe e krijuar në Maqedoni, paradigme të saj ka fatkeqësinë e popullit të shtypur, e përmes letërsisë autorët gjetën formën më të mirë për të dhënë kushtimin dhe ogurzinë e një krahure të rëndë ballkani që duhej të shpërthejë si një *vullkan guximi* për t'i thënë stop dhunës dhe nënshtimit përballë pushtuesve që vinin një pas një.

Letërsia shqipe në Maqedoni kishte fatin e njëjtë me të popullit shqiptar. Ajo anatemohet, censurohet, pengohet dhe digjet. Vitet që pasuan, përmirësimi i kushteve, komunikimi interkulturor, qarkullimi i librit mes lexuesve dhe studiuesve dhe në botë, përkthimi në disa gjuhë të botës, ndikoi në ngritjen e letërsisë shqipe të Maqedonisë drejt Olimpikut letrar kombëtar. Arlind Farizi në studimin e tij për lirikat e Murat Isakut, përmend dhe faktin se: Fatkeqësia më e madhe që sot kësaj ditë përjetohet mes krijuesish është konstatimi i turpshëm nga doktorë shkencash të

Tiranës dhe Kosovës duke e quajtur këtë letërsi si *letërsi e Tjetrit, letërsi maqedonase*, letërsi që s'bën pjesë në *sistemin periodik të letërsisë kombëtare*. Këto stereotipa dhe paragjykime shkencore i kontribuojnë ngritjes dhe forcimit të *Murit shqiptar* dhe penguan me të madhe qarkullimin e vlerave që ka letërsia shqipe në Maqedoni.³⁷

Në kumtesën "*Letërsia shqipe e Kosovës, vështrim diakronik*"³⁸ poeti dhe kritiku nga Struga Agim Vinca shkruan: "*Letërsia shqipe në Kosovë është pjesë përbërëse e letërsisë shqipe në përgjithësi*". Janë "*fijet e pakëputura*" kombëtare ato që bashkojnë pandashëm letërsinë e Kosovës, letërsinë shqipe në Maqedoni me atë të Shqipërisë. Letërsia e Kosovës dhe e Maqedonisë nuk duhet të studiohet në kontekst të letërsisë ish Jugosllave shkakut se ajo *letërsi e përgjithshme* sot u takon gjuhëve dhe popujve të veçantë...

Për të studiuar letërsinë shqipe në Maqedoni, nisma e së cilës mbarështohet në pikëpamjet subjektive të *lexuesit*, duhet zbuluar reagimet individuale - psikologjike të krijuesve të saj. Letërsia dramaturgjike mbetet si e padëshiuruar për studime, drama ka jetën e saj në skenë ose film, por nga informacionet e mia, kam të dhënë se shumë shpejt regjisori A. Thaci përgatit film të metrazhit të shkurtër, pikërisht të mbështetur mbi dramën e Abdyazis Islamit. Ja një dëshmi se drama që po lexohet mund të kalojë te arti më i shtrenjtë te filmi.

Studiuese "*jo lexuesi i thjeshtë*" e konsideron literaturën e poetëve të shenjtë dhe prej saj asimilon "*dukurinë semantike*", e cila i nevojitet lexuesit "*të pjekur*", do të kuptojë logjikën bazë të tekstit. Kënaqësia që na ofrohet nga leximi i poezive të krijuesve shqiptarë në Maqedoni lidhet me një mijë fije dhe me të *kuptuarit e tekstit*³⁹ si tërësi fjalësh. Kuptimin dhe domethënien e letërsisë shqipe në Maqedoni ia jep vetëm *lexuesi* i kultivuar dhe *kritika*. *Kritiku implicit* reagon ndaj letërsisë, në të njëjtën mënyrë sikurse edhe ndaj secilës përvojë jetësore. Ai veprën letrare e lë të depërtojë nëpër sistemin e tij karakteristik të vështrimit shkencor, duke projektuar në tekst botën personale të fantazisë. *Fantazia* dhe *letërsia* nuk ekzistojnë në mënyrë latente. Në të ndodhet vetëm materiali, nga i cili, secili lexues do të krijojë vetë *trillin* e tij, që nuk është e thënë se koïncidon me trillin e shkrimtarit. *Veprat nuk kanë fantazi, ato i kanë njerëzit*. Lessingu thoshte: "*Nëse Zoti do të mbante në dorën e djathtë gjithë të vërtetën, kurse në të majtën vetëm*

³⁷ Arlind Farizi, Universi i vendlindjes në lirikën e Murat Isakut, Tringa, 2010, Tetovë, f. 11

³⁸ Vinca, Agim, *Kërkime universitare*, Gjirakastër, 2009, nr.1

³⁹ Lotman, Jurij, *Struktura na umetničkiot tekst*, Makedonska reč, Skopje, 2005, f. 43

kërkimin, që nuk resh kurrë, të së vërtetës: - edhe sikur ky kërkim të shpinte veç në gabime, çdo herë e gjithmonë, - nëse do të më thoshte: Zgjidh!”, përlësisht do të turesha te dora e tij e majtë e do t’i thosha: “o Atë, më jep këtë, sepse si do që të jetë, e vërtetë e kulluar të përket vetëm ty!”⁴⁰. Dhe dredhia prej prestidigjatori e resh pas kërkimit...

Po e nxjerr në pah sfidën time prej studiueseje të re, në studimin e dramave të një shkrimtari të panjohur fillimisht për mua por tash, pas leximeve, shumë të afërt dhe kureshtar. Studimi që në çastin e trajtimit të temës për letërsinë dramaturgjike paraqet sfidë ku mungojnë modelet e studimit dhe se drama është e rëndë për studim. Aq më shumë rëndon fakti dhe informacionet për letërsinë e kësaj ane janë disi si të ndara në shkenca të përgjithshme të studimit të letërsisë shqipe. Ajo që ka ndodhur në letërsinë shqipe të pjesës ishullore të letërsisë sonë kombëtare është e pashembullt dhe me pasoja të pariparueshme sot e kësaj dite. Kritika e qëllimshme komuniste, ideologjike, inferiore, apo e pandërgjegjshme e ka çuar atë në skajin e fundit, pasi gjithçka është vetë-parë e përjashtuar prej panoramës së plotë të letërsisë kombëtare shqiptare. Çdo përpjekje që përdor të njëjtat kritere për të vënë RREGULL NËNSHTETËSIE si përjashtim prej lojës, është e destinuar të dështojë. Disa kritik e studiues më me nam të Shqipërisë të cilët tentojnë që në planet për hartimin e një HISTORIE TË RE TË LETËRSISË KOMBËTARE “përjashtojnë” poetët më të mirë të Maqedonisë Murat Isakun dhe Abdylazis Islamin! Letërsia bashkëkohore shqipe absolutisht shpjegohet pa këto dy autorë! Ja një dëshmi që tregon qartë sindromin e inferioritetit dhe molisjes së vërtetë e të turpshme shkencore dhe hallakat tmerrshëm *hartën e identitetin* e kësaj letërsie si KOMBËTARE.

Përpjekja e studimit shkencor duhet të fillojë nga leximi formal dhe më pas te një rilexim studimor i dramave, lexim duke ruajtur anësh shënime, emra të personazheve, analizë të botërave të tyre delikate, gjuhë e diskurse të personazheve, dialogje mes tyre, që përbëjnë në fund një studim mbi të shkruarit e letërsisë dramaturgjike shqipe që krijohet në Maqedoni dhe për ta pozicionuar verprën e tij te nivelet më të larta të vlerave që ka historia e zhvillimit të fjalës artistike shqipe bashkë me shënimet t’u vihen në shërbim të letërsisë edhe matanë kufirit. Kërkesa është të diskutohen ligjshmëritë e përgjithshme, që më në fund të japin karakteristikat apo identitetin e një *letërsie nacionale*.⁴¹ Agron Tufa do shtonte se: *Letërsia shqipe është e*

⁴⁰ Todorov, Cvetan, *Poetika e prozës*, Panteon, Prishtinë, 1990, f.3

⁴¹ Hamiti, Sabri, *Tematologjia*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2005, f. 53

ngjashme me relievin e thyer të hartës gjeografike të atdheut.⁴² Mbase kjo e dhënë është e saktë. “Letërsia është një urë shpirtërore si e dërguar nga Zoti për të bashkuar njerëzit dhe popujt, me shumë e më tepër forcë se çdo lidhje e aleancë tjetër. Prandaj, ajo duhet ndihmuar të dalë nga izolimet e të qarkullojë lirshëm”⁴³. Jo për të shtuar një studim mbi dramën e një shkrimtari të cilin e njohim shumë pak lexuesit jashtë Maqedonisë, e shumë pak të lexuar përtej këtij kufiri administrativ, por, për të shterë në studim shkencor relativitetin e mungesave të studimeve të këtilla mbi autorë të mirëfilltë të letërsisë shqipe që krijohet në Maqedoni. Këto vonesa për letërsinë janë “*Humbje eskiliane*”.

Opusi i tij krijues i mbi dyzet veprave letrare, i orientuar në të gjitha zhanret, pastaj si në letërsinë për të rritur, ashtu edhe në letërsinë për fëmijë dhe të rinj, e bëri autorin më kompleks në mbarë letërsinë shqipe, veçmas në atë që u krijua në Maqedoni, në pjesën e dytë të shek. XX.

A. Islami rrjedhën e ka nga një familje kurbetqarësh gajranë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, semimaturën në Tetovë dhe për të kryer këtë shkollë ai udhëtoi nga dhjetë kilometra në ditë. Edhe pse ishte në moshë shumë të njomë, ai përballoi borën dhe shiun për të ardhur në grupin e njerëzve të pavdekshëm. Shkollën Normale (pedagogjike për mësues) dhe Akademinë e Lartë i kreu në Shkup. Me këto përgatitje shkollore serioze, shpejt ra në sy të mirë të popullit dhe punoi disa kohë mësues nëpër fshatra, më vonë në qytet. Shpejt e angazhuan për këshilltar pedagogjik në Këshillin e Rrethit të Tetovës. Nuk ishte njeri i qetë, gjithmonë kishte një shpirt të trazuar prej fisnikërie. Më 1970 nisi punën si gazetar, e më vonë redaktor i emisioneve të rubrikës së kulturës në Radio Shkupi, ku edhe u pensionua.

Ky pensionim ka qenë mjaft enigmatik, pasi pikërisht në vitin 1979 u shtrëngua nga pushteti i kohës si nacionalist. Në këto momente të krizës politike, A. Islamit i duheshin edhe katër vjet pune për të dalë në pension. Duke e kuptuar gjendjen e renduar shpirtërore e shëndetësore të poetit, mjekët tetovarë, përmes disa diagnozave të mundshme, ia mundësuan një pension të parakohshëm. Për poetin, ky rast ishte një buzëqeshje e fatit në fatkeqësi.

Pasi që autorin e kemi njohur personalisht, mund të themi që ai nxiti dhe ndihmoi shumë krijues të rinj që t’i rreken pendës dhe fletores në fushën e letërsisë. Karakteristikë thelbësore është se ky krijues kurrë nuk e hoqi pendën nga dora, deri në momentet e fundit të jetës, siç do të

⁴² Tufa, Agron, *Brezi9 (magazinë për art dhe kulturë)*, Brezi9, maj, Tetovë 2004, f. 13

⁴³ Çiraku, Ymer, *Gjurmime në letërsinë shqiptare*, Albas, Tetovë, 2003, f.3

thoshte Odhise Grillo, “për lexuesit e vegjël dhe të mëdhenj i këndon zemra në gjuhën shqipe dhe po krijon vepra të reja!”⁴⁴

Poeti e dramaturgu, tregimtari e romancieri, publicisti e eseisti, tani, nga më të njohurit në letrat shqipe për të rritur e për të rinj, na befason se si i përballoi të gjitha sfidat e jetës, të cilat i pati goxha të rënda dhe përsëri nuk e lëshoi lapsin nga dora, sikur të kishte një laps magjik dhe sikur të kishte lindur një organizëm me ngjyrë stilolapsi në vend të gjakut. Ai në radhë të parë nuk ka qenë me shëndet të mirë, ka lënguar nga sëmundja e diabetit dhe sëmundje të tjera. Pastaj, djali i tij, Idrizi, i vdiq shumë i ri, kohën kur ishte absolvent i mjekësisë. Më vonë, njëra nga vajzat i vdiq në moshë relativisht të re. Herë pas herë i ndjekur nga pushteti dhe shumë sfida të tjera që, si për çudi, tërë këtyre bllokadave sikur donte t’u bënte ballë përmes shkrimeve të tij, vepra këto, të cilat e tejkaluan numrin 60. Nga këto, shumë refleksione të reja presim nga vepra e fundit në dorëshkrim ”Testamena”, që për momentin ruhet në sirtarët e prof. Zeqir Kadriut, e cila shpresojmë se do të zbardhë shumë gjëra rreth Tetovës dhe tetovarëve dhe më gjerë.

Edhe ne që i kemi hyrë pak rreshtave për këtë Ante, nuk e kemi aspak lehtë, pasi është nga krijuesit më kompleks, jo vetëm në hapësirën shqiptare të Maqedonisë, por edhe më gjerë. Kritika shumë pak e ka prekur, aty këtu, nga kritikët e mëdhenj si: R.Qosja, Ramadan Musliu e ndonjë tjetër, pasi nuk ka mundur çdokush të hyjë në botën krijuese të tij. Në pjesën për fëmijë edhe më pak është i përmendur, thuajse aspak, pasi edhe në pjesën e letërsisë për fëmijë ndryshon fare nga të tjerët, qofshin ato krijues nga Maqedonia apo nga mbarë hapësirat shqiptare.

Veprat e tij të përcaktuara për lektyrë shkollore ishin : "Korrieri Artan Arta", poemë për më të vegjlit, " Kujtime dhe Ëndrra"; drama “Agimesha e ngujuar në shtatë shpella”⁴ . Krijoi mbi tridhjetë vepra letrare edhe pse shumë pak përmendet në letërsinë shqipe . Disa nga veprat e tij janë : “Këngët e zgjuara”, Prishtinë 1968.Vjersha për të rritur, “Era dhe vargjet”, Prishtinë 1964, “Mengjezi në fshat”, vjersha për fëmijë, Shkup 1965, “Soditje nga toka”, Prishtinë 1969, “Barka ndër vale”, vjersha për të rritur,Shkup 1971, “Kujtime dhe ëndrra”, vjersha e tregime për fëmijë, Prishtinë 1972, “Oaza”, vjersha për të rritur, Shkup 1973, “Gurgurina”, vjersha për të rritur, Prishtinë 1974, “Fatiana”, roman për të rritur, Prishtinë 1975, “Ujrat”,vjersha për të rritur,Shkup

⁴⁴ Odhise Grillo, shkrimtar shqiptar për fëmijë, Tiranë 1997, f. 94.

1976, “Korrieri Artan Arta”, poemë për pionierët, Prishtinë 1976, “Agullina”, sonete për të rritur, Prishtinë 1978, “Dritë në sfond”, kurora sonetike dhe vjersha për të rritur, Prishtinë 1980, “Për qepallat e qiellit varen plepat”, vjersha për të rritur, Shkup 1983, “Përralla popullore nga Sharri”, folklor, Shkup 1985, “Maje malesh”, Prishtinë 1985, “Vajza e panjohur”, roman për fëmijë dhe të rinj, Prishtinë 1985, “Meleroti”, vjersha, poemë e tregime për fëmijë, Shkup 1986, “Krimi në tempull”, roman për fëmijë e të rinj, Prishtinë 1987, “Yjet e vendlindjes”, Tiranë 1987, “Romancat e një nate vere”, vjersha për të rritur, Shkup 1987, “Pëllumbi sqepartë”, roman për fëmijë, Shkup 1988, “Zërat nga maja”, vjersha për të rritur, Prishtinë 1988, “Endrrat bulojnë në Eldorado”, poemë dhe vjersha për të rritur, Shkup 1990, “Vogëlushi i fshatit Lashtor”, poemë, tregime për fëmijë e të rinj, Shkup 1992, “Hekurani në Artas” roman për të rinj, Shkup 1993, “Agimesha e ngujuar në shatë shpella”. Dramë për fëmijë e të rinj, Shkup 1994, “Kuvendi i guximtarëve”, dramë për fëmijë e të rinj, Shkup 1994, “Arianda”, dramë për fëmijë e të rinj, Shkup 1994, “Arianda”, dramë për fëmijë e të rinj, Shkup 1994, “Pëshpëritjet e udhëtarit plak”, poezi për të rritur, Shkup 1995, “Nica”, poemë për të rritur, Tetovë 1995, “Tatuazhe”, tregime për të rritur, Shkup 1996.

Studiusi dhe miku i shkrimtarit prof. Vebi Bexheti thotë se: Veprimtaria letrare aq e gjithanshme dhe motivesh e zhanresh të shumta e A. Islamit, pas një rrugëtimi të gjatë, jo vetëm që e pasuroi letërsinë tonë por e begatoi atë edhe me vlera të reja. Nga e tërë kjo vepër që u krijua në hapësirën kohore 50-vjeçare, me këtë rast u përcaktova për disa poema të tij, të përfshira në përmbledhjen “Përtej kohës”, botuar në vitin 2002 në Tetovë.⁴⁵ Ndërroi jetë më 16 gusht 2005, në Tetovë.

⁴⁵ Bexheti Vebi, Kronika historike në tri poemat e Abdylazis Islamit, Konferenca IX Shkencore Ndërkombëtare me temë “Veprimtaria letrare e Abdylazis Islamit dhe Murat Isakut” (me rastin e 10 vjetorit të ndarjes nga jeta), mbajtur më 20 nëntor 2015 në UEJL, Tetovë, f. 22

KAPITULLI I TRETË

3.0 DRAMA PËR FËMIJË TË ABYLAZIS ISLAMI

Ejup Ajdini për Abdylazis Islamin thotë se: “Krijuesit e mëdhenj nuk largohen nga bota e fëmijëve”. Në dramën e tij për fëmijë shprehen prirje të veçanta për formimin e tërësive të ngjeshura. Në të gjitha linjat përmes monologut intuitiv e të përshtatshëm si dhe shprehjeve bindëse jep mesazhe dhe sjell vizione e pikëpamje mbi jetën. Në dramën për fëmijë shquhet me frymëzimin ekzaltues. Shprehjet subtile dhe të bukura jo rrallë sentencioze, shpalosin botën e pasur shpirtërore të fëmijëve, entuziazmin, vrullin, shpirtin e pastër, sinqeritetin dhe fisnikërinë e tyre. Ai personazhin e jep si njeriu i urtë, i qetë, i heshtur dhe stabil i adhuruari i fëmijëve dhe i dashur nga intelektualët. Ka ndërtuar poetikën dramaturgjike në linjën tematike stilistike të natyralizmit psikologjik, ndërsa në epiqendër të shqetësimeve ka njeriun e rëndomtë në botën moderne, ballafaqimin me sfidat bashkëkohore, sprovat e jetës dinamike urbane, mënyrën e përshtatjes dhe përballimin e anktheve dhe peshës së rëndë të *mbijetesës në të cilat sjell mesazhe të vlefshme për humanizimin edhe fisnikërimin e jetës*.

Fillimisht jemi përqendruar te poetika e dramës për fëmijë të Abdylazis Islamit, duke e këndvështuar poetikën e vendlindjes, poetikën e hapësirës dhe poetikën e udhëtimit. Metafora e vendlindjes⁴⁶ janë tipike të Abdylazis Islamit. Karakteristika e dramës për fëmijë mbetet referenca tradicionale e cila ka bazë vendlindjen, mbetet hapësira e cila krijon klaustrofobinë dhe personazhi i *Agimeshës*, që për mendimin tim është personazhi më i bukur i gjithë letërsisë shqipe për fëmijë. Edhe në krijimet për fëmijë autori përdor burime të parapëlqyera nga jeta e rrethina e fisit të tij, prej ndikimeve të letërsisë gojore, por edhe parapëlqen subjektiven dhe individualen. Edhe te dramën ”Agimesha në shtatë shpella”, ai frymëzimin do ta marrë në temat e vendlindjes dhe burimi i frymëzimit të tij do të jetë i veshur nga petku folklorik, ku bëjnë pjesë të gjitha këto elemente, kuptohet edhe ndërhyrja artistike dhe estetike e vetë autorit. Ai përmend shkëmbinj, shpella, lumenj, ujëvara, lisa, disa zogj, zjarre, diellin, hijet etj., të gjitha këto të lidhura shpirtërisht edhe me vendin ku lindi dhe jetoj poeti A. Islami. Leximi i dramave është

⁴⁶ Zeqir, Kadriu, Bota poetike e Abdylazis Islamit, (studim monografik), Blana, Tetovë, 2003, f.75

një përpjekje për të kuptuar, për të bashkëjetuar dhe për t'u ushqyer shpirtërisht nga një shkrimtar dhe mendimtar origjinal dhe i shkëlqyer të letërsisë shqipe të krijohet në Maqedoni. Veprën e tij duhet ta konceptojmë si një sistem apo strukturë shenjash, që i shërben një qëllimi specifik estetik, ta analizojmë si nga aspekti përmbajtjesor, aspekti imazhologjik dhe kulturologjik, që idetë, emocionet që na përcjell personazhi fëmije, pra elementet më tipike nëpërmjet të cilëve shprehet një tipologji dhe fantazi krijuese unike që të përfton me plot delikatesë për t'i takuar plotësisht edhe si lexues fëmije por dhe si studiues. Prandaj, le të studiojmë dramën për fëmijë të këtij autorë me vlerë të gjithë letërsisë dhe le t'i besojmë Bartit se:

“Të lexosh do të thotë ta dëshirosh veprën, do të thotë të duash të jesh vepra, do të thotë ta refuzosh ta dyfishosh veprën jashtë çdo të folurit tjetër pos të folurit të vetë veprës (...) Të kalosh nga leximi në kritikë do të thotë ta ndryshosh dëshirën, do të thotë ta dëshirosh jo më veprën, por ligjërimin e vet (...) Sa shkrimtarë kanë shkruar vetëm se kanë lexuar. Sa kritikë kanë lexuar vetëm për të shkruar”⁴⁷.

⁴⁷ Rolan Bart, *Aventura Semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008, f. 208

3.1 STRUKTURA E DRAMAVE PËR FËMIJË

Dramturgu dhe njohësi i madh i botës së fëmijëve, Abdylaziz Islami, shkrimet e tij në fushën e letërsisë dramturgjike i ka të qartë, të shkurtëra, pa ngarkesa të mëdhaja semantike, kuptimesh të thella, të kapshme për një sy e vesh fëmije, të çliuara nga metaforat e rënda që përjashtojnë nivelin e perceptimit të fëmijës.

Historitë e njohura që vijnë në formë kujtimesh të së kaluarës, tragjedia, epi e ndonjë tjetër e humbin garën me llojet që po krijoheshin në frymën e kërkesave të kohës ku një rol të pakontestueshëm e kanë pasur ndryshimet e përgjithshme shoqërore, zhvillimi i hovshëm kapitalist dhe krijimi i kombeve dhe i shteteve nacionale. Epi e zëvendësoi romani, ndërsa tragjedinë lloji i ri drama, e cila duhet të ketë dalë nga komedia dhe tema e saj shoqërore, mirëpo këto i trajton pa efektet komike. Edhe më herët në kuadër të llojeve ka pasur përzierje elementesh, në tragjedi, situatë komike dhe anasjelltas, që jep shenjës të qartë të strukturës së llojllojshme të dramës. Zhanri i ri, nëse mund të thuhet, që i trajton problemet e njeriut, konfliktin e individit me të tjerët ose me rrethin pa iu frikësuar elementeve tragjike, por edhe pa e kursyer individin nga fshikullimet komike e satirike dhe të përshtatura për fëmijë e të rinj. Megjithatë, edhe përfundimet tragjike të dramës individin nuk e ngritin në nivel të heroit tragjik për arsye se ai në të vërtetë nuk i shpreh idelitet as interesat e kolektivit, as është përfaqësues i tyre. Heroi i dramës është individ që e ndjen thellësisht vuajtjen dhe me gjithë shpirt lufton për t'i zgjidhur çështjet e mëdha jetësore dhe në këtë përpjekje nuk kalon në ekstremin komik, në krijimin e vesit të caktuar nga virtyti. Tematikisht drama është fare afër tematikës së prozës, llojeve representative të saj, romanit e novelës. Struktura e saj ka brum pikërisht në prozë. Konfliktet janë po ato njerëzore, pa ato prapavijat mitike të përzierjeve hyjnore në faktin e njerëzve, megjithëse edhe këtu shpesh mund të hetohen e mira dhe e keqja, nderi dhe turpi, ndjenja fisnike dhe ajo morale, mirëpo trajtimi i tyre është si konflikt njerëzor, pa lënë të kuptohet që prapa qëndrojnë forca të tjera kundër të cilave njeriu s'mund t'ia dalë.

Të përmendim tendencën e rikthimit të romantizmit si një tendencë për krijimin e strukturave të tjera, mikrostruktura të huazuara nga mitet dhe të zhvendosura në kontekste bashkëkohore dhe moderne, pastaj teatrin lirik të Çehovit, dramën simboliste, ekspresioniste etj, këto janë disa shnja që rrugës ka ecur drama e sodit. Në mbarim të shekullit të kaluar dhe në fillim të shek. XX Luixhi Pirandelo shquhet për dramën në të cilën individi kërkon identitetin e vet. “Drama e tij në përgjithësi shquhet për mendimin e thellë, gjë që e afron me dramën filozofike në të cilën një ide themelore përmban esencën e konfliktit dramatik p.sh. dramat e Zhan Pol Sartrit, Albert Kamysë etj”.⁴⁸

Veprimtaria e tij në drama ka këtë strukturë, të katërta janë të përmbledhura në një tekst të vetëm⁴⁹:

1. MRIZONI DHE ERIDIKA⁵⁰;
2. AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA;
3. KUVENDI I GUXIMTARËVE; DHE
4. ARIANDA.

Qëllimi i dramave për fëmijë dhe të rinj të Abdylazis Ilsamit nuk është vetëm krijimi i rolit për “jetën e shpirtit njerëzor”, por që edhe anës së jashtme të tij t’ia japim formën artistike dhe imazhe mitike dhe të vendlindjes, imazhe të personazhit sharrjan. Prandaj aktori – personazhi brenda dramave të lartshënuara nuk duhet ta përjetojë rolin vetëm nga ana e brendshme, por edhe nga ana e jashtme. Këto drama janë të shkruara dhe të paramenduara për jetë skenike, madje kanë të shënuara dhe idetë për kostumografi, enterier dhe eksterier, emërtime personazhesh që bartin në vete autorite të rralla mitike.

Autori ka tentuar dhe ia ka arritur me sukses që ta pasqyrojë jetën delikate dhe shpeshherë jetën subkoshiente të personazhit sharrjan, dhe e ka parë si të domosdoshme që t’i zotërojë aparatet inçizuese të hapësirës sharrjane me të gjitha bukuritë, me të gjitha nuancat shumë të

⁴⁸ Zejnullah Rrrhmani, Teoria e Letërsisë, Botim i dytë, SHB “Faik Konica”, Prishtinë 2008, f. 346-347

⁴⁹ Abdylazis Islami, Drama për fëmijë e të rinj, Vatra, Shkup, 2010, 161

⁵⁰ Kjo vepër është dhe roman, po në në fokus të studimit kemi dramën. Romani dhe drama, kanë dallimet, në roman ka shumë përkshkrime ndërsa te drama kalohet drejtpërdrejt në dialog, në veprim...Romani është botuar në Tetovë, Çabej, 2004,

ndjeshme dhe shumë të komplikuar të zërit e të trupit të personazhit që vepron brenda tekstit. Dy elemente të rëndësishme, si zëri dhe trupi me një mjeshtëri të madhe dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, duhet të shprehin, aty për aty dhe me saktësi, ndjenjat e brendshme dhe shumë delikate dhe gati të pakuptueshme. Ja përse aktori duhet, shumë më tepër sesa drejtimet e tjera artistike, të kujdeset jo vetëm për aparatin e brendshëm që krijon procesin e përjetimit, por edhe për aparatin e jashtëm, për aparatin e trupit i cili tregon në mënyrë besnike rezultatet e punës krijuese të ndjenjave – shprehjen e formës së jashtme të tij. Në këto drama për fëmijë e të rinj, del se subkoshienca ka një ndikim të madh. Edhe në fushën e të krijuarit me subkoshiençën nuk mund të krahasohet as teknika më e urryer e artit dramatik, megjithëse ajo pretendon vendin e parë me plot besim.

3.1.1 Analizë e dramës për fëmijë e të rinj “MRIZONI DHE EURIDIKA”.

Duke ndaluar që në titullin i cili duhet itnerpretuar sepse nuk përmbën një titull rëndomësie. Çka nënkupton fjala Mriz, prej të cilës del emërtimi i personazhit Mrizoni? MRIZ *m*.

1. Vend i freskët e me hije ku kalojnë vapën bagëtia, mërzim; hije; koha e vapës me të madhe gjatë ditës, mesdita. *Pushojnë mrizeve. Mërzejnë në mriz. Bëjnë mriz bagëtia: mërzejnë*

*Rri mriz. *mospërf*. a) rri pa punë, e kalon kohën kot, mërzen; b) rri si i hutuar a si përgjumësh.

Shih edhe: mrizoj mrijoj⁵¹

Emërtimi i personazheve ka një rëndësi të veçantë për letërsinë, aq më shumë për dramat që si lexues kanë fëmijët, nga mrizoj, mrizë, në MRIZON, si një emër përkdhelës dhe të lezetshëm dhe lehtësisht të rrokshëm për fëmijët. Dhe emri tjetër, i gjinisë femër, EURIDIKA, që ka për brum krijues emrin EURIDIKA, të mitit grek të Orfeseut dhe Euridikës, për hir të mbamendjes dhe regjistrimit më të lehtë në kujtesën e një fëmije, emër i këndshëm femreje. Bazuar në mitin antik grek të Orfeut, i cili u bë i famshëm me dashurinë ndaj gruas së re,

⁵¹ <https://fjale.al/mriz>

Euridikës. Mirëpo, fati nuk ishte në anën e tij që me të të jetojë në lumturi: duke mbledhur lule Euridika shkeli gjarpërin helmues dhe, kur Orfeu vrapoi, pasi që e dëgjoji britmën e saj, ajo tani më ishte e vdekur.

Drama fillon me formulën dramatike vetat⁵². Të ndara në tri shtresa:

Nga shtresa e lartë dalin personazhet të cilët përveç emërimit jepen dhe profesionet, pozicionet, rolet:

1. Artasi – mbreti
2. Garesha – mbretëresha
3. Gjetmiri – princi
4. Euridika – princesha
5. Oborrtarët
6. Shërbëtorët

Struktura është e thjeshtë. Një familje mbretërore me oborrtarë dhe shërbëtorë, fëmijë dhe grua.

Në shtresën e ulët:

7. Shoqet e princeshë Euridikë
8. Mrizoni – trimi
9. Babai i trimit
10. Nëna e trimit
11. Dy shokët e trimit
12. Plaku i urtë

Struktura këtu del si e paramenduar. Një famijë e trimit të cilin e paracakton autori në fillim të një djali të guxishëm dhe trim duke i vënë dhe emrin MRIZON. Familjen e trimit e jep pa emër, thjesht të pacaktuar, duke treguar përkatësinë familjare, si baba e nënë dhe shokë të trimit, në fund fare fut një personazh të plakut të urtë, detyra e të cilit do të shihen në vazhdim, pse plaku i urtë, si tregohet urtia e ti... Këtë personazh autori e ka strukturuar jashtëzakonisht bukur dhe është ndër personazhet prej të cilit mund të fitojë mjaft një lexues fëmijë.

Nga shtresa e përbindëshave:

13. Vigan Tutukata, përbindësh

⁵² Abdylaziz Islami, Drama për fëmijë e të rinj, Vatra, Shkup, 2010, f.5

14. Lulebora, gruaja e Tutukatës

15. Dy vajzat e Viganit, përbindëshit

16. Dashamirët e Viganit.⁵³

Kjo shtresë ka elemente të fabulës, e cila është një ndër strukturat më të rëndësishme të krijimtarisë dramaturgjike të Abdylazis Islamit. Kjo shtresë ka digresionin e vetë personazhit negativ, përbindëshit, i cili ka grua dhe dy vajza dhe në fund disa dashamirës të dhëna në kontekst të personazhit kolektiv. Këtu është dhe elementi katarzist, që duhet të përjetojë fëmija gjatë leximit, të ndajë personazhin negativ nga ai pozitiv, të marrë të duhurën dhe të dobishmen dhe të spastrojë ndërgjegjen nga bëmat e personazhit negativ.

Veprimi ose thënë më mirë ngjarja, ndodh në kohë të krizës, para erës së re kur një vigan i quajtur, Tutukata, një emër i mirëmenduar për fëmijë, vepron sipas dëshirës së vet, kundër mbretërisë së skirtarëve, fisit ilir të malit Skard, që është emërvënia e vjetër antike e malit Sharr, vendlindjes së autorit. Viganit kur hidhërohej pse nuk i dërgonin ndonjë viktimë, ndonjë virgjëreshë, që ta hante, e ndante lumin në drejtimin të një mbretërie tjetër. Këtu duhet thënë se në aspekt të perceptimit të fëmijës, tema e virgjërisë nuk zë vend, por ky tekst është menduar për një moshë tjetër, atë të viteve 16 vjeç e sipër. Viganit, për viktimë të rradhës kërkonte Euridikën,, vajzën e mbretit të skirtarëve. Dhe gjithë ngjarja zhvillohet e përmbushur me bafasi dhe të papritura. Meqë teskti ka si figurë të fuqishme alegorinë, ku gjërat nuk thuhën dhe aq direkt e lë mendjen e një fëmijë të krijues iluzionet e veta, përgjatë leximit të ruajë kërkshërinë deri në fund, kur pritet të njihet me të vërtetën përrallore të tekstit.

Autori që në tekst ka treguar për mënyrën se si duhet vëshur personazhe duke mos lënë asgjë në mendjen e tij të krijojë ndonjë kostumografi të ardhshme, nëse dikush e ka menduar që këtë tekst ta vendosë në skenë. Autori kujdeset sikur një regjisor filmi për çdo detaj, për çdo veprim për çdo fjalë, ai e sheh ngjajrjen si një shirit filmi.

Drama nis me bisedën e këndshme që zhvillojnë fëmijët me Ukë Arianitin, i cili në drama tregohet si plaku më i vjetër në mëhallën e vjetër. Fëmijët kanë emra të njohur, Ylber, Zana, Zamir, Të gjithë fëmijët- personazh kolektiv... Ata e lusin plakun që t'u tregojë ndonjë përrallë qoftë dhe ndonjë ngjarje të vërtetë nga jeta e tij. E pyesin për fiset ilire, për skirtarët të cilët sipas dijeve të fëmijëve, nga ato që kishin dëgjuar se gjoja kishin jetuar në mijëvjeçarin e parë të erës së re. Plaku i butë u thotë se do ua tregojë një legjendë, e cila mund të jetë dhe baladë. Rrëfimi i

⁵³ Abdylazis Islami, Drama për fëmijë e të rinj, Vatra, Shkup, 2010, f.5

tij mjeshtëror, nis për ngjarjen e viganit Tutukata. Autori e tipizon këtë personazh legjende si një njeri të ashpër, i keq, vrasës, i fuqishëm dhe i pashpirt dhe si i tillë i ka munduar shumë njerëzit e kësaj ane, sharrjanët. Rrëfimi vazhdon në skenë ku imagjinohet pamja e parë. Aty zhvillohet biseda mes mbretit dhe mbretëreshës, të cilët bisedonin për ëndrrat e trazuara që kishin ditëve të fundit. Shihni ëndrra sikur dikush në ërrësira ia kishte këputur krahun e djathtë. Kjo ka simbolikën se diçka e keqe po afrohet dhe do të ndodhë. Andaj thirr ëndërshtpjeguesin. Këtë personazh e ftojnë urgjent për të dhënë komentin e tij prej shpjegues se çka simbolizon kur në ëndër sheh se dikush ta prek krahun dhe atë krahun e djathtë?. ai vjen dhe ndër fjalët që ia thotë mbretit përmend errësirën, dhe thotë se mund të afrohet ndonjë krizë e madhe, e meqë kjo puna e krahut i ka ndodhur gruas suaj, bie që kriza do të ndodhë brenda pallatit mbretëror...

Në skenën e radhës futet Kasneci. Personazhi i Kasnecit është krijuar si një nga ato personazhe që shfaqen njëherë, vjen jep një lajm dhe ik. Ai vjen në pallat dhe jep lajmin se vigani Tutukata, e paska ndarë lumin dhe e ka drejtuar ka mbretëria tjetër fqinje, sepse ajo i paska dërguar disa viktimë si gosti, ndërsa ne nuk i kemi dërguar asnjë fli. Kasneci tregon se ai kërkon vajzën e tyre Euridikën për viktimë, për ta pjekurr në furrë dhe për ta hëngër për drekë. Elementi i fantazisë është i pranishëm në nivel të dukurisë së pamundshme, por përderisa bëhet fjalë për teskt për fëmijë, imagjinata shkon deri te e pakufishmja. Mbreti pranon të japë bijën dhe të ruajë mbretërinë me idenë se atdheu kërkon kurban, dhe se në radhë të parë është mbretëria e pastaj familja. “Bija jonë do jetë kurban i atdheut”⁵⁴

Skena tjetër është biseda për të bindur bijën për të shkuar te vigani. Kjo pjesë ngjan në skena mitike greke të tipit Agamemnon, i cili për të ruajtur pushtetin martohet me nënën e tij, dhe se për të më i rëndësishëm është pushteti dhe mbretëria dhe më pak familja. Euridika shfaqet e tmerruar nga kërkesa e babait të saj. Pas bindjes ajo thotë me plot guxim se nëse atdheut i duhen kurbanë unë do të shkoj duke kënduar madje. Madje lë amanet që pasi të vdesë lumit të cilin do e kthejë kah mbretëria jonë të quhet Arta, që historia jonë ta mbajë mend, se ky lumë do ujitë fushat tona dhe do kemi bereqet. Euridika shfaqet si një femër e guximshme, e cila pranon të flijohet për të mirën e atdheut. Kjo ngjan në legjendën e kështjellës së Rozafatit, kur përfundi një prefecie njerëz nga nuset i është paracaktuar fati të murroset me idenë e qëndresës së kështjellës. Këtë mit që flijimit, të huazuar mjeshtërisht nga miti grek por të rikomponuar bukur në situatën tonë, Abdylazisi e jep përmes Euridikës sonë.

⁵⁴ Abdylazisi Islami, Drama për fëmijë e të rinj, Vatra, Shkup, 2010, f.12

Skena tjetër, jep imazhet e Euridikës e cila e veshur si nuse dhe duke nusëruar. Princi si personazh i parë që shfaqet në këtë skenë, thotë se në vend të Euridikës do të shkoj unë, jo motra, që tregon dhe dashurinë e madhe motër e vëlla. Ndërsa mbeti i thotë se jo, ti duhet të jesh trashëgimtari im. Euridika niset e përcjell me bekimet e babait, duke kënduar këngët e flijimit, këngët e lirisë dhe jetës:

Jam nisur për të shkuar

Ja, por shkoj për t'u flijuar

Po flijohem për atdhe,

Liri do të ketë ndër ne.⁵⁵

Notat e dhimbjes që po lë jetën e saj, janë nota të guximit. Janë nota që këndojnë këngën e flijimit për të mirën e familjes, kombit. Atdheut i duhet një fli dhe ajo jam unë, thotë Euridika. Merr po ashtu dhe përkrahje nga shoqet e saj. Dhe lëvdohet për guximin e saj. Skena ka imazh dhimbjesh, lot, dorë të ngritura lamtumirash...

Rrugës Euridika takohet me Plakun e urtë. Mbase autori qëllimisht e ka nxjerrë në mes udhe të takojë me një personazh që njihet për nga këshillat e tij të arta. Euridika e pyet atë se cila është rruga për të vigani, te përbindëshi Tutukata. Plaku ndjen dhimbje për këtë nismë të Euridikës andaj jep një këshillë që kjo të kërkojë një trim, i cili do të ndeshet me viganin dhe do të shpëtojë dhe familja dhe mbretëria. Trimi pos fuqisë që duhet ta ketë duhet të di dhe ta bëjë dredhi. Trimi duhet ta nderojë Tututakën, se do t'i sjellë një shtambë me raki të mirë, dhe atë do ta zë gjumi... Ku ta gjejmë këtë trim me kaq virtyte të rralla si trim, dredhak dhe të fuqishëm.? Plaku i thotë se gjatë rrugës do e gjesh, po dhe ia jep një shtambë me raki me vete.

Skena tjetër jep familjen e trimit, nënën, babain dhe dy shokët e tij. Nga fjalët e trimit shihet si ai është një i vendosur për ndihmë atdheut. Se kam shokë të fortë dhe se ne i duhemi atdheut për ta shpëtuar. Ai niset vetë pa ndonjë përkrahje nga familja dhe shokët.

Afër një shpelle trim Mrizoni e takon princeshën Euridikë. Kur ajo i thotë se po shkoj të përbindëshi se më ka kërkuar të flijohem unë për të mirën e atdheut. Ai kur i dëgjon këto fjalë merr një guxim të paparë dhe jep fjalë se do të luftojë me përbindëshin. Princesha i thotë se

⁵⁵ Abdylaziz Islami, Drama për fëmijë e të rinj, Vatra, Shkup, 2010, f.16

duhet ta dehim me rakinë të cilën ia kishte dhënë plaku i urtë. Ai thotë se pasi të mbysim përbindëshin, unë do shkoj të mbreti dhe do u them se ti e ke mbytur. Plani nis me takimin e Mrizonit me Tutukatën, duke i thënë se të kam sjell princeshën dhe një shtambë me raki. Pije rakinë se të shtohet oreksi e pastaj e ha princeshën. Ai dehet dhe Mrizoni i bie me “çomangë” në ballë. I bie aq sa më nuk ngrihet dhe vdes përbindëshi. Euridika e falëndëroi aq shumë për faktin se ajo jeton ende, se shpëtoi mbretërinë, dhe atdheun. Në këtë pjesë hyjnë dhe dashamirët e Tutukatës të cilët pasi dëgjojnë për trimërinë e Mrizonit të cilës i thonë se do të mbytim ne, se do të lidhim me zinxhirë deri sa të vdesë ashtu i lidhur. Ai përgjigjet se dhe unë kam aq shokë sa për të luftuar me ju. E zënë Mrizonin dhe e lidhin me duar lartë në dru. Malltretohet keq. Burgimi i Mrizonit ishte çnjerëzor. Mrizonin e shpëtojnë shokët. Pasi futen në pallatin e Tututakës takojnë vajzat e tij dhe nënën. Trimi jep mendimin se vajzat do të martohen me dy shokët e tij. Trimi i kthehet nënës së vajzave, duke i thënë se ju jeni grua e ndershme dhe se keni qenë robëresha e tij, dhe se jeni nga fisi i skirtarëve... Madje i tregon se unë quhem Mrizon, jam nga qyteti Oenej, qyteti i vjetër i Tetovës...

Skena e fundit, është ajo në pallatin e mbretit. Ëndërrshpjeguesi jep dhe njëherë sigurinë se çdo gjë ka ecur siç ka menduar. Drama përfundon në një atmosferë të hareshme pas një fitoreje mbi përbindëshin dhe kthimin e lumit ka ana e tyre. Kënga, valleja, janë elemente skenike që shënojnë një fund të lumtur dhe një fitore mbi të ligën.

3.1.2 ANALIZË E DRAMËS PËR FËMIJË AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA

Që në analizën e dramave, në rrugën studimore të studimit të kësaj gjinie letrare na del problematika e njohur e mungesës së studimeve. Si fillim në studimin konkret të dramës së marrë në analizë na jepet informacioni i parë se gjinia letrare e veprës- dramë për fëmijë dhe të rinj me tri pamje. Tri pamjet janë të ndërlidhura mjeshtërisht që në fund japin një përfundim të këndshëm për lexuesin. Kjo dramë e njohur ndër ne, por dhe ndër studiues, ka qenë dhe lektyrë shkollore, nuk përjashtoj dhe rekomandimet e shumta të dashamirëve të letërsisë për ta lexuar. Leximi dallon nga studimi. Në leximin e parë dhe formal ne ndjejmë vetëm kënaqësi leximi, në studim thellohem madje në botën e brendshme të personazheve, me gjuhën e tyre, në dialogimin e tyre tipik dhe mjeshtërisht të përcaktuar në nivelin e personazhit. Forma e diskursit të tekstit në dramë- dialogu.

Rrëfim në vetën e tretë (në prologun e dramës) dhe në vetën e parë (në vetë personazhet). Koha e ngjarjes (stina)- dimër (kohë me dëborë, akull e acar). Këto kohë dhe këto pamje janë sikur të jepen imazhe filmike. Teksa lexon këtë dramë na jepet fotografia e madhe se ku saktësisht ndodh ngjarja, si janë të strukturuar personazhet, si flasin, si zihen e pajtohen. Lehtë hetohet katarzisi aristotelian. Kënaqësia është e dyfishtë kur në fund të studimit, del përfundimi shkencor dhe i pagabueshëm se kjo dramë është vlerë madhore e letërsisë shqipe. Madje jo vetëm e letërsisë shqipe në Maqedoni por dhe më gjerë.

Mjedisi i ngjarjes ka rëndësinë e saj, drama duhet të ketë të qartë ku zhvillohet ajo në ç'mjedis - në fillim të dramës del ambienti i fshatit, më pas del ambienti malor. Hapësira malore është ajo e Sharrit, sharrjani, poetika e hapësirës së Sharrit si një ndër malet më të njohur madje, pjesë të jetës së autorit të kaluar në fshat reflektohen dhe në këtë vepër dramatike.

Motivi letrar- pushtuesi dhe sundimtari i të tjerëve (në këtë rast, ujku). Tematika, pushtues e sundues, janë një nivel më i lartë pranimi e perceptimi për lexuesin fëmijë, andaj kjo dramë shkon më lartë, në një tjetër horizont pritjeje, të lexuesi i rinj. Fëmijë pak dinë për pushtues, ose

dinë për diçka sipërfaqesore, ndërsa të rinjtë, kanë përjetuar, parë, shikuar, dhe njohur terminologjinë e luftërave. Nuk paraqesin terme të reja dhe të pakuptimshme.

Subjekti- aktual- tema e ngjarjes merret nga përditshmëria dhe trajtohet në mënyrë artistike.

Narratori i dramës- vetë autori. Autori flet më gojën e personazheve. Kjo është një e përbashkët e disa dramave të tij. Jo vetëm në këtë dramë, zëri i narratorit jehon në shumicën e dramave. Raste të tilla do përmendim më poshtë.

Shtresat e dramës- fëmijët (shtresa popullore/shoqërore), kafshët dhe zana e malit (shtresa fantastiko-shkencore/mitologjike).

Tema- ndihma e të tjerëve për realizimin e dëshirave të fëmijëve. Fëmijët janë pika e dobët e autorit, për to autori shtron tema që të njëjtit të argëtohen gjatë leximit, të kuptojnë vlerën e tyre brenda shtëpisë dhe shoqërisë. Pa fëmijë një shtëpi është boshe. Fëmijët janë metafora krijuese e Abdylazis Islamit.

Idetë e dramës- bashkimi i të gjithëve për të qenë të fortë përballë pushtuesit dhe sunduesit; krijimi i harmonisë jetësore; pastrimi i zemrës nga të këqijat dhe pastrimi i trurit nga mendimet e këqija dhe të dëmshme, si për veten ashtu edhe për rrethin shoqëror apo familjar.

Veprimi- zhvillohet në kohë me trazira e zallahi.

Gjuha e personazheve- e thjeshtë, e lehtë, e kuptueshme, koncize...

Intrigë veprimi- lexuesi që në fillim dëshiron të dijë se çka do të ndodhë më tej dhe nëse arrin të shpëtohet Agimesha, rreth së cilës sillet e tërë ngjarja.

Lloji i kompozicionit- i shkallëzuar (ngjarja zhvillohet kah një qëllim i caktuar, por rrugës has në pengesa që e ngadalësojnë; çdonjëra pengesë përbën një shkallë në zhvillimin e fabulës/kompozicionit të dramës).

Personazhet njerëz- Bekimi, Marta, Miranda, Astriti, Gentiana, Dritoni, Redoni, Gëzimi, Edona, Driloni, Blerimi dhe Flora⁵⁶.

⁵⁶ Abdylazis Islami, (2000), Drama për fëmijë dhe të rinj, Vatra, Shkup, f. 47.

Personazhet kafshë- ujku torollaku, dhelpër kumbara, vjedull balusha, dreri brirëmadhi, luani babaxhani, Agimesha, zana e malit.

Figura mitologjike- zana e malit (një vajzë e bukur dhe me tipare fizike si në poezitë popullore).

Element letrar- kënga (shoqëron dramën që nga fillimi deri në fund).

Drama ka qartësinë e të shkruarit dhe shprehjen e mendimeve në formë të thjeshtë.

Simbolikat e personazheve kafshë- ujku simbolizon të keqen, pushtuesin, kokëfortin, keqbërësin, nopranin dhe vetmitarin; dhelpëra simbolizon dinakërinë dhe dredhinë; lepuri simbolizon frikacakun dhe të butin; vjedulla simbolizon të bukurën dhe krenarinë; dreri simbolizon krenarinë, butësinë, lirinë, pavarësinë; ariu simbolizon gjumashin, të fortin; luani simbolizon sundimtarin, të fortin dhe zotëruesin e mjedisit.

Simbolikat tjera në dramë: Agimesha (ylli i mëngjesit) simbolizon vullnetin, dëshirat, ëndrrat dhe gëzimet e fëmijëve; shpella simbolizon errësirën dhe fshehtësinë; dielli simbolizon ngrohtësinë, ndriçimin, shpresën, jetën dhe lindjen e ditës së re; lulja simbolizon të bukurën, butësinë dhe ndjeshmërinë (delikaten).

Personazhet njerëz janë të rrafshët (të sheshtë)- njëdimensionalë dhe sipërfaqësorë. Mund të përshkruhen nga ana e lexuesit vetëm me një fjali të vetme.

Ndërsa personazhet kafshë janë të rrumbullakët- kompleksë dhe shumëdimensionalë; por edhe dinamikë (të gjallë)- ndryshojnë në një mënyrë të rëndësishme për shkak të veprimit të ngjarjes.

Fjalët e personazheve janë me efekt të madh te lexuesi.

Drama jep karakterizime të drejtpërdrejta- ngaqë personazhet zbulohen përmes fjalëve të tyre, me ç'rast bëjnë edhe zbulimin e mendimeve personale për çështjen që ngërthen drama.

Personazhet negativë ndëshkohen- në këtë rast kemi ujkun (simbolizues i njeriut të keq).

Personazhet tregojnë ndjenja të frikës, sfidës dhe të mospëlqimit.

Konflikti në dramë zhvillohet ndërmjet ujkut dhe kafshëve të tjera, të cilat ishin në përkrahje të fëmijëve për realizimin e dëshirave dhe ëndrrave të tyre fëmijërore.

Mosha e personazheve- mosha fëmijërore.

Ndodhia e papritur që përfshin personazhet në tensionin qendror të dramës- ngujimi i Agimeshës nga ana e ujkut, në shtatë shpella.

Tensioni i dramës- tension i lartë (maksimal).

Përsheptimi i krizës në dramë vjen nga bashkimi i të gjitha kafshëve për ta mposhtur ujkun dhe fuqinë e tij mbi të tjerët, të cilët ai i shihte dhe i mendonte si më të dobët.

Zgjidhja e krizës bëhet me ndihmën e luanit (ndihmë që vjen nga një mendje e arsyeshme).

Dëshirat dominuese të personazheve- harmonia dhe realizimi i ëndrrave të fëmijëve.

Format reaguese të personazheve- racionale, instinktive, emocionale dhe intuitive.

Ideali heroik në dramë- ndihma dhe fuqia e luanit.

Qëllimi i autorit- të bindë fëmijët se vetëm me anë të bashkimit dhe mendimeve të mira mund të arrihen gjërat që nga një këndvështrim vetjak duken të pamundshme dhe të parealizueshme.

3.1.3 ANALIZË E DRAMËS PËR FËMIJË KUVENDI I GUXIMTARËVE

Gjinia letrare e veprës së tekstit të cilin e morëm në analizë është tekst - dramë për fëmijë dhe të rinj me pesë pamje. Të pesë pamjet janë një tërësi e pandashme kuptimore dhe si e tillë e plotëson veprën duke bartur veprim nga njëra pamje te tjetra për të dhënë në fund një tablo të këndshme artistike dhe estetike. Vlera e këtij teksti dramatik është mënyra dhe forma e diskursit të tekstit në dramë- dialogu. Dialogu i jep jetë tekstit dramatik. Dhe kur ajo dedikohet për një lexues fëmijë e të rinj, kërkon mjeshtri shkrimi, të cilën autori në fjalë e ka me bollëk, sepse është specialist i njohje së perceptimit të fëmijës.

Narratori- vetë autori. Në këtë dramë modeste, kudo na del autori, me të gjitha nishanet, e këtë mund ta hetojnë më së miri njohësit e Abdylazis, njohësit e rrethanave jetësore të autorit të cilat përmes fjalës së bukur, përmes letërsisë shfaqin tablo të rëndësishme dhe këndshme për

lexim te lexuesi. E rëndësishmë është të përmendet se çfarë subjekti ka ky tekst modest dhe i shkurtër dramatik. Subjekti- aktual- ngjarja merret nga përditshmëria dhe trajtohet në mënyrë artistike/figurative.

Shtresat e veprës- fëmijët (shtresa popullore/shoqërore), zana e malit e shtriga (shtresa mitologjike/fantastiko-shkencore).

Rrëfim në vetën e tretë (në prologun e dramës) dhe në vetën e parë (te e folura e personazheve).

Koha e ngjarjes- në prag të Vitit të Ri; stina- dimër me ngrica, acar e dëborë. Koha e veprimit të personazhit është e një vlerë të rëndësishme po aq sa dhe hapësira. Drama është e shkruar për t'u botuar si tekst dramatik, por kjo dramë i ka mundësitë që me një lehtësi të vogël të shndërrohet në teatër, shfaqje teatrore ose film për fëmijë. Ka gjithçka të duhur, mungon kamera dhe muzika...

Mjedisi i ngjarjes- dhoma në të cilën stoliset bredhi i Vitit të Ri.

Motivi letrar- pushtimi i tjetrit dhe vjedhja/robërimi i ëndrrave të tij.

Tema- të ndriçohet dhe rregullohet rruga nga e cila vjen e mira dhe gëzimi.

Idetë- mposhtja e së keqes; bashkimi i fuqive; sigurimi i harmonisë dhe gëzimit fëmijëror.

Gjuha e personazheve- e thjeshtë, koncize, e qartë dhe e lehtë.

Lloji i kompozicionit- i shkallëzuar (ngjarja zhvillohet kah një qëllim i caktuar, por rrugës has në pengesa që e ngadalësojnë atë; çdonjëra pengesë përbën një shkallë në zhvillimin e fabulës/kompozicionit të dramës).

Figura mitologjike- Zana e malit, Babadimri, Shtriga.

Simbolikat e dramës: shtriga simbolizon të keqen, të pashpirtën dhe të kobshmen; errësira simbolizon të keqen, frikën dhe të turpshmen; mjegulla simbolizon ndalimin, frikën, mbylljen, të zezën dhe zymtësinë; ndërsa zana e malit simbolizon vajzën e bukur dhe shpirtmirë, e cila gjithmonë gjendet në ndihmë të personazheve që kanë nevojë për ndihmë dhe janë të dobët që si të vetëm t'u bëjnë ballë vështirësive që hasin në rrugë apo në jetën e përditshme.

Element letrar- kënga.

Drama ka qartësinë e të shkruarit dhe shprehjen e mendimeve në mënyrë të qartë e të natyrshme.

Efekti i fjalëve të personazheve të lexuesi i dramës- i lartë, i duhur dhe i fuqishëm.

Drama në fillim jep atmosferë pikëlluese, por më vonë me zhvillimin dhe arritjen në kulmin e ngjarjes, ajo bëhet pozitive, me mbretërim të gëzimit dhe haresë.

Personazhet- Astriti, Arianiti, Miranda, Arlinda, Sihana, Ylli, Bardhyli, Brikena, Bjeshkani, Babadimri, Zana e malit, Polaroidi (Ylli Polar), fëmijët përcjellës të babadimrit, fëmijët rrugaçë/maniakë, kusari ëndrravjedhës, shtriga kobzezë dhe Fiqfiriqi.⁵⁷

Personazhet pozitivë -(fëmijët, Zana e malit, Babadimri)- janë të rrafshët (të sheshtë)- njëdimensionalë dhe sipërfaqesorë, të cilët mund të përshkruhen me një fjalë të vetme. Ndërsa personazhet negativë- (fëmijët rrugaçë, shtriga, kusari, Fiqfiriqi)- janë të rrumbullakët-kompleksë, dinamikë (të gjallë), për shkak se ndryshojnë në mënyra të rëndësishme për shkak të veprimit të ngjarjes dhe krijimit të situatave negative për të tjerët (në rastin tonë në dramë, për fëmijët).

Drama jep karakterizim të drejtpërdrejtë ngaqë personazhet zbulohen përmes fjalëve dhe veprimeve personale, me ç'rast bëhet edhe zbulimi i mendimeve personale për çështjen që bëhet zotëruesja kryesore në dramën në fjalë.

Personazhet tregojnë ndjenja të frikës, sfidës, pasigurisë, mospëlqimit, kundërshtisë...

Personazhet negativë humbin dhe pësojnë tërheqjen nga skena me pikëllim nga humbja e madhe.

Konflikti zhvillohet ndërmjet personazheve pozitivë dhe negativë.

Mosha e personazheve- mosha fëmijërore.

Ndodhia e papritur që përfshin personazhet në tensionin qendror të dramës është krijimi i Mjegullës së Zezë për ta penguar ardhjen e Babadimrit për t'i gëzuar fëmijët dhe për t'ua realizuar dëshirat e tyre për një vit të mbarë e të suksesshëm në shkollë dhe mësim.

⁵⁷ Po aty, f. 83.

Kriza e dramës zgjidhet nga ndihma e Zanës së Malit.

Tensioni i dramës- në fillim i lartë, ndërsa më vonë i ulët dhe i natyrshëm.

Dëshirat dominuese të personazheve fëmijë- harmonia, realizimi i ëndrrave, suksesi në mësim, gëzimi dhe hareja e të rriturve (në këtë rast, i prindërve të tyre).

Ideali heroik- ndihma dhe zgjidhja e problemit nga Zana e Malit.

Format reaguese të personazheve- racionale, instinktive, emocionale dhe intuitive.

Intrigë veprimi- lexuesi që në fillim dëshiron të dijë se ç'do të ndodhë më tej me personazhet dhe nëse ata do të arrijnë që me veprime pozitive të shpëtojnë Babadimrin nga Mjegulla e Zezë e krijuar enkas për dëm dhe mposhtje të tij, dhe nëse ai arrin që të vijë deri te fëmijët rreth bredhit.

Intrigë dënimi- heronjtë/personazhet negativë nuk gëzojnë simpatinë e lexuesit për shkak të cilësive të tyre djallëzore e dinake.

Intrigë e zbritjes- duke pasur parasysh se personazhet/heronjtë negativë janë vetë ata që sjellin fatkeqësinë e të tjerëve dhe pikëllimet e tyre, lexuesi refuzon të bashkëndjejë me të, pavarësisht gjërave që atyre mund t'u ndodhin.

Intrigë degjenerimi- të gjitha iniciativat dhe veprimet negative të personazheve/heronjve negativë dështojnë njëra pas tjetrës dhe në të shfaqet dëshpërimi dhe zymtësia shpirtërore.

Qëllimi i autorit- të jep shembuj se si duhet vepruar për ta ndihmuar një njeri me ëndrra të mëdha, qofshin ato edhe ëndrrat e singerta fëmijërore.

3.1.4 ANALIZË E DRAMËS PËR FËMIJË “ARIANDA”

Që nga leximi i parë i këtij teksti na del se gjinia letrare e veprës është mirëfilli një dramë për fëmijë dhe të rinj me dymbëdhjetë pamje. E theksoj pos dramë për fëmijë është për të rritur

për shkak të temave që trajtohen brenda dhe të tillat rrokin perceptime përtej një mendjeje lexuesi fëmijë. Forma e diskursit të tekstit në dramë- dialogu.

Si personazh në cilësinë e protagonistes së dramës del personazhi me emrin e bukur shqip Arianda. Dimë se dramat përgjithësisht cilësohen si tekste me dialogje, me veprime personazhesh, të cilët kur komunikojnë ndodh të ketë konflikt dramatik. Po kjo dramë modeste, e shtrirë në disa faqe, jepet në rrëfimin e saj në vetën e tretë (në prologun e dramës) dhe në vetën e parë (në vetë personazhet), një ndarja interesante por e bukur dhe jo e qëllimtë

Personazhet në këtë dramë të shkurtër për nga shkrimi i saj janë Pellazgjini, Arianda, Kësulëkuqja, Pinokio, Zana e Malit, Ujku, Iriqi, E Përhitura, Borëbardha, Lejleku, lulja Gentiana, lisi Plak.⁵⁸ Nga kjo galeri personazhesh shihet se ata janë të huazuar, janë personazhe të njohur dhe të njëjtët rimerren dhe përdoren në konotacionet të autorit, si përshtatje, risemantizime, huazime mitike, vlera të rralla të mitologjisë ilire dhe të huaj, gjithmonë në funksion të tekstit artistik.

Lidhur me vlerën ose thënë më mirë subjektin e dramës, na del se është një subjekt shumë aktual. Veprimi dhe ngjarja merret nga e përditshmja jonë jetësore dhe trajtohen në mënyrë artistike me figura dhe elemente letrare e stilistike. Mjeshtria e Abdylazis Islamit është pikërisht te strukturimi i personazheve, duke i veshur ata me nuanca më të mira realiste, fantastike, dhe imagjinatë të cilën mund ta rrokë lehtëzi një sy e mendje fëmije. Narratori në këtë dramë sa shfaqet si vetë autori. Drama patjetër ka dhe kohën e ngjarjes e cila në rastin tonë jepet pikërisht në natë, në terr. Shtresat e veprës- shtresa popullore (Arianda dhe gjyshi i saj), shtresa e kafshëve/shpesëve (iriqi, lejleku), shtresa bimore (lulja Gentiana), shtresa mitologjike (Zana e Malit), shtresa fantastiko-shkencore (Borëbardha, E përhitura, Kësulëkuqja, Pinokio). Mjedisi i ngjarjes- Lagjja e Vjetër, ambient i dhomës së shtëpisë në fillim dhe ambienti i pyllit. Motivi tematik letrar- kënaqja e dëshirave personale.

Tema- përmbushja dhe realizimi i dëshirave; gjetja e idealit dhe jetesa në atdheun e të parëve. Idetë e dramës- puna ndihmon në arritjen e gjithçkaje; moshumbja e shpresës dhe vrapimi pas fatit më të mirë dhe të ndritur jetësor.

⁵⁸ Po aty, f. 113.

Gjuha e personazheve është e qartë, e thjeshtë, koncize, e pastër dhe e lehtë. E dedikuar pikërisht për një perceptcion fëmije.

Kompozicioni i dramës është ai unazor ngaqë gjatë leximi hetojmë se gjithçka sillet rreth personazhit të Adrianës.

Figura mitologjike- Zana e Malit (vajzë me bukuri të rrallë dhe shpirtmirë, e cila gjithmonë vinte në ndihmë të personazheve pozitivë, të cilët në raste të ndryshme kishin edhe nevojë për të).

Element letrar- kënga.

Drama ka qartësinë e të shkruarit dhe shprehjen e mendimeve në mënyrë të qartë e të natyrshme.

Efekti i fjalëve të personazheve të lexuesit është mjaft i madh dhe i rëndësishëm.

Atmosfera e dramës gati se në të dymbëdhjetë pamjet është pozitive.

Simbolikat në dramë- ujku simbolizon të keqen, pushtuesin, kokëfortin, keqbërësin, nopranin dhe vetmitarin; gjarpëri simbolizon helmuesin dhe fshehtësinë; njerka simbolizon të keqen, të pashpirtien dhe sunduesen shpirtërore; lulja simbolizon të bukurën, delikaten dhe të butën.

Qëllimi i autorit- t'i bindë fëmijët se me mendime dhe zemër të mirë arrihet në fund të rrugës së vërtetë ku ndriçohen të gjitha të fshehtat dhe arrihet kënaqësia e madhe shpirtërore.

Intrigë veprimi- lexuesi që në fillim shfaq dëshirë për të mësuar se çdo të ndodhë me Ariandën.

Personazhet janë të rrafshët (të sheshtë)- njëdimensional dhe sipërfaqesor, ngaqë edhe nga autori/narratori, por edhe nga lexuesi ato mund të përshkruhen me një fjali të vetme e të qartë.

Drama në fjalë e Adbylasis Islamit jep karakterizime të drejtpërdrejta ngaqë personazhet zbulohen përmes fjalëve të tyre personale, me ç'rast njëkohësisht bëhet edhe zbulimi i mendimeve të tyre personale për çështjen që ngërthen drama në vete.

Mosha e protagonistes Ariandë- moshë fëmijërore.

Ndodhia e papritur që përfshin personazhet në tensionin qendror të damës- paraqitja në skenë e ujkut, i cili me urinë e tij kërkonte ushqime të lehta dhe sundimin e të tjerëve.

Kriza e dramës zgjidhet- nga ndihma e Zanës së Malit.

Tensioni i dramës- i ulët (maksimal).

Dëshirat dominuese të protagonistes- harmonia, gjetja e idealit, realizimi i dëshirave dhe ëndrrave të singerta e të pastra fëmijërore.

Format reaguese të protagonistes- racionale, intuitive, instinktive dhe emocionale.

Ideali heroik në dramë- ndihma e të tjerëve në rrugën e përmbushjes së dëshirës së Ariandës.

7.Përfundimi

Krijimtaria letrare në dramën e Abdylazis Islamit, në përgjithësi shquhet si një mbindërtim i fuqishëm i letërsive të mëhershme. Së pari, kjo e dëshmon vetëdijen e autorit se çdo tekst është intertekst dhe se ringjallja e letërsisë paarprake është e patjetërsueshme dhe së dyti, krijuesi e llogarit vetëdijen e lexuesit dhe tipat e ndrrshëm të lexuesve, prandaj edhe lëviz me nivelin e sinjalizimit.

Mendojmë se krijimtaria në 3 dramat e Abdylazis Islamit do t'i ndihmojë lexuesit fëmijë dhe studiuesit pasionantë të kësaj letërsie për të kapur prirjen e natyrshme të shoqërisë për të ndjerë dhe për të mbajtur qëndrimin e saj, të cilin e etiketojmë “fajësi kolektive”. Ky është edhe vetë obligimi i poetit Islami: të kemi një shoqëri qytetare pa shpagë, pa hakmarrje. Për shpirtin e sotëm njerëzor mbase kjo është utopi, deri sa janë stërfuqizuar sërish ish shfrytëzues, persekutorë, provokatorë, të cilët ndërrojnë maskat..

Abdylazis Islami do të ngelet ai shkrimtari i cili përmes shkrimit të dramës për fëmijë i solli shqipes numër të madh fjalësh të përbëra të cilat dhe sot e gjithë ditën përdoren. Miniera nga i nxirte këto fjalë dhe i përpunonte pastaj ishte pikërisht gjuha shqipe, të cilës ia merrte dhe ia kthente dhe rikthente edhe më të bukura.

8.Bibliografia

1. Aliu Ali, Don Kishoti shqiptar, Tiranë, 2010
2. Aliu Ali, Parathënia (Murat Isaku Poezi, Tetovë 2003)
3. Aliu, Ali, *Reflekse letrare*, 1999, Shkup.
4. Aliu, Ali, *Teoria e letërsisë*, 2001, Shkup.
5. Benedikt Dema, Gjergj Fishta, jeta dhe vepra, Romë 1992.
6. Bergson, Henri, *Burimet e moralit dhe fesë*, 2002, Tiranë.
7. Biddulph, Steve, *Sekreti i fëmijëve të lumtur*, 2006, Tiranë.
8. Bruqi, Flori “Gjergj Fishta: Jeta dhe vepra” (1871-1940).
9. Bullo Jorgo, Shpirti i Fjalës, Tiranë 2014
10. Dado Floresha, *Proza nëpër teknikat poetike*, 1997, Tiranë.
11. De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, Rilindja, Prishtinë, 1988.
12. Dedja, Bedri, *Burimet e letërsisë shqipe për fëmijë*, 1978, Prishtinë.
13. Dedja, Bedri, *Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë*, 1971, Tiranë.
14. Deva, Agim, *Fjala e përjetimi*, 1983, Prishtinë.
15. Deva, Agim, *Romani ynë për fëmijë*, Prishtinë. Pa vit të botimit.
16. Farizi Arlind, Universi i vendlinjes në Lirikat e Murat Isakut, Tetovë 2011
17. Field, Linda, *Psikologjia e vetëbesimit*, 2006, Prishtinë.
18. Frojd, Zigmund, *Psikoanaliza femnore*, 2005, Tiranë.
19. Grillo, Odhise, *Panoramë letrare – 2, Nëpër faqet e letërsisë sonë për fëmijë*, 1997, Tiranë.

20. Grillo, Odhise, *Panoramë letrare – 3, Nëpër faqet e letërsisë sonë për fëmijë*. Pa vit të botimit Tiranë.
21. Grillo, Odhise, *Panoramë letrare, (Nëpër faqet e letërsisë sonë për fëmijë)* Pa vit të botimit, Tiranë.
22. Grup autorësh, *Letërsia bashkëkohore shqiptare*, Tiranë 2001
23. Isaku Murat, *Poezi (kompleti)* ,Tetovë 2003
24. Islami Abdylazis - *Poezi 1*, Shkup,2006 ,faqe 305
25. Islami Abdylazis, *Përtej kohës*,Tetovë 2002
26. Jaku Pjetër, *Vlerat letrare në Lahutën e malësisë të Gjergj Fishtës*, Lezhë 2000, Sh.b. Kuvendi.
27. Kadriu Zeqir - *Bota poetike e Abdylazis Islamit (studim monografik)*, Tetovë 2003,faqe,21,22,38,40
28. Kadriu, Zeqir. *Bota poetike e Abdylazis Islamit*,Tetovë 2003
29. Karaj, Theodhori, *Psikologjia e zhvillimit të fëmijës*, 2005, Tiranë.
30. Kroçe Benedeto, “Estetika si shkencë e shprehjes dhe e gjuhësisë së përgjithshme”, “Apollonia”, Tiranë, 1998.
31. Mursi, Muhamed, *Arti i edukimit të fëmijëve*, 2009, Shkup.
32. Mustafa, Avzi, *Hyrje në metodologjinë e punës kërkimore-shkencore në fushë të filologjisë*, 2006, Shkup.
33. Nikoliq Sinisha, *Bota e psikës fëmijërore*, 2006, Shkup.
34. Plasari Aurel, *Fishta – estetikë dhe kritikë*, në: *Hylli i Dritës*, Tiranë 1999.
35. Plasari Aurel, *Fishta meditans, parathënie në librin Fishta, Estetikë dhe Kritikë*, Hylli I Dritës & Shtëpia e librit, Tiranë, 1999.
36. Rexhep Qosja, *Vepra 11 (Kompleti,Prishtinë 2010)*
37. Selmani, Ahmet. *Bashkëbiseduesit e mi*,Tetovë 2000
38. Selmani, Arif, *Bibliografija e letërsisë shqiptare për fëmijë në Maqedoni, 1953-1997, 1988*, Tetovë.

39. Sopaj Nehas, *Letërsia për fëmijë*, 2000, Shkup.
40. Shkodra, Faik, *Letërsi për fëmijë*, 2002, Prishtinë.
41. Veliu, Ibrahim. Parathënia e librit Abdylazis Islami, Poezi, Tetovë 2006
42. Xhavit Aliçkaj, Lahuta e Malcisë e Gjergj Fishtës, Faik Konica, Prishtinë, 2000.
43. Zejneli, Ismail, *Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë*, 2008, Tetovë.
44. Mehmeti, Salajdin, *Nga letërsia shqipe për fëmijë*. Dorëshkrim